

---

# 1. Familjet dhe Kisha në Planin e Perëndisë

<b>1.1 Plani i Perëndisë, Atit, për Familjen e Tij të Përjetshme.</b> . . . . .	<b>2</b>	<b>1.3 Krijimi i Familjeve të Përjetshme</b> . . . . .	<b>3</b>
1.1.1 Familja Paratokësore e Perëndisë . . . . .	2	1.3.1 Bashkëshorti dhe Bashkëshortja . . . . .	3
1.1.2 Qëllimi i Jetës në Vdekshmëri . . . . .	2	1.3.2 Prindërit dhe Fëmijët. . . . .	4
1.1.3 Shlyerja e Jezu Krishtit . . . . .	2	1.3.3 Anëtarët e Pamartuar të Kishës. . . . .	4
1.1.4 Roli i Familjeve në Planin e Perëndisë . . . . .	2	<b>1.4 Shtëpia dhe Kisha.</b> . . . .	<b>4</b>
1.1.5 Roli i Kishës . . . . .	2	1.4.1 Forcimi i Shtëpisë. . . . .	5
<b>1.2 Kthimi tek Ati</b> . . . . .	<b>2</b>	1.4.2 Mbrëmja Familjare. . . . .	5
1.2.1 Ungjilli i Jezu Krishtit . . . . .	2	1.4.3 Forcimi i Individëve . . . . .	5
1.2.2 Roli i Udhëheqësve dhe Mësuesve të Kishës . . . . .	3		

---

# 1. Familjet dhe Kisha në Planin e Perëndisë

---

## 1.1 Plani i Perëndisë, Atit, për Familjen e Tij të Përjetshme

### 1.1.1 Familja Paratokësore e Perëndisë

Familja shugurohet nga Perëndia. Ajo është njësia më e rëndësishme në kohë dhe në përjetësi. Madje përpara se të lindeshim në tokë, ne ishim pjesë e një familjeje. Secili prej nesh “është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë” me “një natyrë dhe të ardhme hyjnore” (“Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”, *Ensign*, nëntor 1995, f. 102). Perëndia është Ati ynë Qiellor dhe ne jetuam në praninë e Tij si pjesë e familjes së Tij në jetën paratokësore. Atje morëm mësimet tona të para dhe u përgatitëm për jetën në vdekshmëri (shih DeB 138:56).

### 1.1.2 Qëllimi i Jetës në Vdekshmëri

Për shkak të dashurisë së Perëndisë për ne, Ai përgatiti një plan që përfshinte ardhjen tonë në tokë, ku do të merrnim trupa dhe do të provoheshim, në mënyrë që të mund të përparonim dhe të bëheshim më shumë si Ai. Ky plan quhet “plani i shpëtimit” (Alma 24:14), “plani i madh i lumturisë” (Alma 42:8) dhe “plani i shëlbimit” (Alma 12:25; shih edhe vargjet 26–33).

Qëllimi i planit të Perëndisë është të na udhëheqë drejt jetës së përjetshme. Perëndia shpalli: “Kjo është vepra ime dhe lavdia ime—të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Jeta e përjetshme është dhurata më e madhe e Perëndisë për fëmijët e Tij (shih DeB 14:7). Ajo është ekzaltimi në shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale. Nëpërmjet planit të shpëtimit, ne mund të marrim këtë bekim, të kthimit në prani të Perëndisë dhe marrjes së një plotësie të gëzimit.

### 1.1.3 Shlyerja e Jezu Krishtit

Me qëllim që të fitojmë ekzaltim në mbretërinë e Perëndisë, ne duhet të kapërcejmë dy pengesa të jetës në vdekshmëri: vdekjen dhe mëkatin. Meqë ne nuk mund të kapërcejmë vetë asnjërin prej pengesave, Ati Qiellor dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, që të jetë Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Sakrifika shlyese e Shpëtimtarit e bëri të mundur për të gjithë fëmijët e Perëndisë që të kapërcejnë vdekjen fizike, të ringjallen dhe të marrin pavdekësinë. Shlyerja e bëri gjithashtu të mundur për

ata që pendohen dhe e ndjekin Atë, që të kapërcejnë vdekjen shpirtërore, të kthehen në prani të Perëndisë që të banojnë me Të dhe të fitojnë jetë të përjetshme (shih DeB 45:3–5).

### 1.1.4 Roli i Familjeve në Planin e Perëndisë

Si pjesë e planit të Atit tonë Qiellor, ne u lindëm në familje. Ai krijoi familje për të na sjellë lumturi, për të na ndihmuar të mësojmë parime të sakta në një mjedis me dashuri dhe për të na përgatitur për jetën e përjetshme.

Prindërit kanë përgjegjësinë jetike që t’i ndihmojnë fëmijët e tyre të përgatiten për t’u kthyer tek Ati Qiellor. Prindërit e përmbushin këtë përgjegjësi duke u mësuar fëmijëve të tyre që të ndjekin Jezu Krishtin dhe të jetojnë ungjillin e Tij.

### 1.1.5 Roli i Kishës

Kisha siguron organizimin dhe mjetet për t’u mësuar ungjillin e Jezu Krishtit të gjithë fëmijëve të Perëndisë. Ajo siguron autoritetin e priftërisë për të administruar ordinancat e shpëtimit dhe ekzaltimit për të gjithë ata që janë të denjë dhe të gatshëm t’i pranojnë ato.

---

## 1.2 Kthimi tek Ati

### 1.2.1 Ungjilli i Jezu Krishtit

Plani i shpëtimit është plotësia e ungjillit. Ai përfshin Krijimin, Rënien, Shlyerjen e Jezu Krishtit, si dhe të gjithë ligjet, ordinancat dhe doktrinën e ungjillit. Ai na siguron mënyrën për të përjetuar gëzim në jetën në vdekshmëri (shih 2 Nefi 2:25) si edhe bekimin e jetës së përjetshme.

Nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, ne mund të pastrohemi e të shenjtërohemi nga mëkati dhe të përgatitemi që të hyjmë sërish në praninë e Atit tonë të Përjetshëm. Për ta marrë këtë bekim, ne duhet të ndjekim parimet dhe ordinancat e ungjillit (shih Nenet e Besimit 1:3). Ne duhet:

1. Të ushtrojmë besim në Zotin Jezu Krisht, Birin e Vetëmlindur të Perëndisë.
2. Të kthehemi tek Perëndia me anë të pendimit të sinqertë, duke pasur një ndryshim të zemrës dhe duke rrëfyer e braktisur mëkatet.
3. Të marrim ordinancën shpëtuese të pagëzimit për heqjen e mëkateve.

4. Të konfirmohemi anëtar/e i/e Kishës dhe të marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë me anë të vendosjes së duarve.
5. Të durojmë deri në fund duke mbajtur besëlidhjet e shenjta.

Këto parime janë dhënë mësim që nga koha e Adamit. Kur arrijmë t'i kuptojmë e t'i besojmë këto të vërteta dhe të marrim një dëshmi të qëndrueshme për Jezu Krishtin, ne përpiqemi fort t'u bindemi urdhërimeve të Tij dhe dëshirojmë t'i ndajmë bekimet tona me familjen tonë dhe të tjerët (shih 1 Nefi 8:9–37). Me themelin e sigurt të dëshmisë, elementet e tjera të aktivitetit të Kishës vijnë natyrshëm.

Rritja shpirtërore personale ndodh kur i afrohem Perëndisë nëpërmjet lutjes, studimit të shkrimit të shenjtë, meditimit dhe bindjes. Nefi dha mësim:

“Pasi ju të keni hyrë në këtë shteg të ngushtë dhe të ngushtuar, unë do t'ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vini re, unë ju them juve, Jo; pasi ju nuk keni arritur deri këtu përveçse me anë të fjalës së Krishtit, me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë.

Kështu që, ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:19–20).

Secili prej nesh është përgjegjës përpara Perëndisë për të mësuar e për të mbajtur urdhërimet e Tij dhe për të jetuar ungjillin. Ne do të gjykohejmë sipas veprimeve tona, dëshirave të zemrave tona dhe llojit të njeriut që jemi bërë. Kur bëhemi ndjekës të vërtetë të Jezu Krishtit, ne provojmë një ndryshim të fuqishëm të zemrës dhe “nuk kemi më prirje të bëjmë keq” (Mosia 5:2; shih edhe Alma 5:12–15; Moroni 10:32–33). Kur jetojmë ungjillin e Jezu Krishtit, ne rritim pak e nga pak, duke u bërë më shumë si Shpëtimtari për t'i dashur e për t'u shërbyer të tjerëve.

## 1.2.2 Roli i Udhëheqësve dhe Mësuesve të Kishës

Udhëheqësit dhe mësuesit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse, përpiqen shumë që t'i ndihmojnë të tjerët të bëhen pasues të vërtetë të Jezu Krishtit (shih Mosia 18:18–30). Për t'i ndihmuar individët dhe familjet në këtë përpjekje, ata:

1. Japin mësim dhe dëshmojnë për doktrinat e kulluara të ungjillit të Jezu Krishtit.
2. Forcojnë individët dhe familjet në përpjekjet e veta për të mbajtur besëlidhjet e tyre të shenjta.
3. Japin këshillë, mbështetje dhe mundësi për shërbim.

Përveç këtyre, disa udhëheqës priftërie kanë autoritetin që të mbikëqyrin kryerjen e ordinancave shpëtuese të priftërisë.

## 1.3 Krijimi i Familjeve të Përjetshme

Familjet janë qendrore për planin e Perëndisë, i cili siguron një mënyrë që marrëdhëniet familjare të shtrihen përtej varrit. Ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta të tempullit, të mbajtura besnikërisht, na ndihmojnë të kthehemi në prani të Perëndisë, të bashkuar përjetësisht me familjet tona.

### 1.3.1 Bashkëshorti dhe Bashkëshortja

Ekzaltimi në shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale mund të arrihet vetëm nga ata që e kanë jetuar besnikërisht ungjillin e Jezu Krishtit dhe janë vulosur si shokë të përjetshëm.

Vulosja e bashkëshortit dhe bashkëshortes për kohën dhe përjetësinë me anë të autoritetit të priftërisë – njohur gjithashtu si martesë në tempull – është një privilegj dhe detyrim i shenjtë që të gjithë duhet të përpiqen fort që ta marrin. Ajo është themeli i një familjeje të përjetshme.

Tiparet e shpirtave mashkullorë dhe femërorë janë të tilla që ata plotësojnë njëri-tjetrin. Burrat dhe gratë janë paracaktuar që të përparojnë së bashku drejt ekzaltimit.

Zoti i ka urdhëruar bashkëshortët e bashkëshortet të kapen pas njëri-tjetrit (shih Zanafilla 2:24; DeB 42:22). Në këtë urdhërim, fjalët të *kapesh pas* duan të thonë të jesh plotësisht i përkushtuar dhe besnik ndaj dikujt. Çiftet e martuar kapen pas Perëndisë dhe njëri-tjetrit duke i shërbyer e duke e dashur njëri-tjetrin dhe duke mbajtur besëlidhjet në besnikëri të plotë ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj Perëndisë (shih DeB 25:13).

Një çift bashkëshortësh duhet të bëhet një në krijimin e familjes së tyre si baza e një jete të drejtë. Bashkëshortët e bashkëshortet shenjtorë të ditëve të mëvonshme, lënë pas jetën e tyre si beqarë/e dhe vendosin martesën si përparësinë e parë në jetën e tyre. Ata nuk lejojnë asnjë njeri ose interes tjetër që të ketë përparësi më të madhe në jetën e tyre sesa mbajtja e besëlidhjeve që kanë bërë me Perëndinë dhe njëri-tjetrin. Megjithatë, çiftet e martuara vazhdojnë t'i duan e t'i mbështesin

prindërit dhe motrat e vëllezërit e tyre, ndërsa përqendrohen tek familja e vet. Në mënyrë të ngjashme, prindërit e mençur e kuptojnë se përgjegjësitë e tyre familjare vazhdojnë gjatë jetës me një qëndrim dashurie dhe inkurajimi.

Të qenit një në martesë kërkon një bashkë-pjesëmarrje të plotë. Për shembull, Adami dhe Eva punuan së bashku, u lutën dhe adhuruan së bashku, bënë sakrificë së bashku, u mësuan ungjillin fëmijëve të tyre së bashku dhe vajtuan për fëmijët e tyre të pabindur së bashku (shih Moisiu 5:1, 4, 12, 27). Ata qenë të bashkuar me njëri-tjetrin dhe me Perëndinë.

### 1.3.2 Prindërit dhe Fëmijët

“Urdhërimi i parë që Perëndia i dha Adamit dhe Evës, lidhej me potencialin e tyre për të qenë prindër si bashkëshort e bashkëshorte. . . . Urdhërimi i Perëndisë për fëmijët e Tij që të shumohen dhe të mbushin tokën, mbetet i vlefshëm” (“Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”). Nëpërmjet projektit hyjnor, si burri edhe gruaja janë thelbësorë për të sjellë fëmijët në jetën në vdekshmëri dhe për të siguruar mjedisin më të mirë për të rritur dhe edukuar fëmijët.

Të qenit plotësisht të përmbajtur seksualisht përpara martesë dhe besnikëria e plotë brenda martesë mbrojnë paprekshmërinë e kësaj përgjegjësie të shenjtë. Prindërit dhe udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse duhet të bëjnë gjithçka munden për ta përforcuar këtë mësim.

Në lidhje me rolin e etërve dhe të nënave, udhëheqësit e Kishës kanë dhënë mësim: “Etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi dhe janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet e tyre. Nënata janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Në këto përgjegjësi të shenjta, etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë” (“Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”). Kur nuk ka baba në shtëpi, nëna e kryeson familjen.

Prindërit kanë një përgjegjësi të caktuar hyjnisht “për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore, për t’i mësuar ata ta duan e t’i shërbejnë njëri-tjetrit, të zbatojnë urdhërimet e Perëndisë dhe të jenë qytetarë që u binden ligjeve kudo që jetojnë” (“Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”; shih edhe Mosia 4:14–15).

Prindërit e mençur u mësojnë fëmijëve të tyre që të zbatojnë fuqinë shëruese, pajtuese dhe forcuese të Shlyerjes brenda familjeve të tyre. Po

ashtu si mëkati, dobësitë vdekjeprurëse, lëndimi emocional dhe inati janë kushte që i ndajnë fëmijët e Perëndisë prej Tij, po të njëjtat kushte mund t’i ndajnë pjesëtarët e familjes nga njëri-tjetri. Secili pjesëtar i familjes ka përgjegjësi që të përpiqet fort për unitetin e familjes. Fëmijët që mësojnë të përpiqen fort për unitetin në shtëpi, do ta kenë më të lehtë ta bëjnë këtë jashtë shtëpisë.

### 1.3.3 Anëtarët e Pamartuar të Kishës

Të gjithë anëtarët, edhe nëse nuk janë martuar kurrë ose nuk e kanë familjen në Kishë, duhet të përpiqen fort për idealin e të jetuarit në një familje të përjetshme. Kjo do të thotë të përgatitemi për t’u bërë bashkëshortë të denjë dhe etër ose nëna të dashura. Në disa raste këto bekime nuk do të përmbushen deri në jetën tjetër, por synimi përfundimtar është i njëjtë për të gjithë.

Anëtarët besnikë, rrethanat e të cilëve nuk u lejojnë atyre të marrin bekimet e martesës së përjetshme dhe të prindërimit në këtë jetë, do të marrin gjithë bekimet e premtuara në përjetësi, me kusht që të mbajnë besëlidhjet që kanë bërë me Perëndinë.

## 1.4 Shtëpia dhe Kisha

Në mësimet dhe praktikat e ungjillit të rive-ndosur, familja dhe Kisha ndihmojnë dhe forcojnë njëra-tjetrën. Për t’u kualifikuar për bekimet e jetës së përjetshme, familjet duhet të mësojnë doktrinat dhe të marrin ordinancat e priftërisë, që janë të disponueshme vetëm nëpërmjet Kishës. Për të qenë një organizatë e fortë dhe jetike, Kisha ka nevojë për familje të drejta.

Perëndia ka zbuluar një model përparimi shpirtëror për individët dhe familjet nëpërmjet ordinancave, mësimëve, programeve dhe aktiviteteve, që përqendrohen tek shtëpitë dhe mbështeten nga Kisha. Organizatat dhe programet e Kishës ekzistojnë për të bekuar individët e familjet dhe nuk janë qëllime në vetvete. Udhëheqësit dhe mësuesit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse kërkojnë t’i ndihmojnë prindërit dhe jo t’u zënë vendin apo t’i zëvendësojnë ata.

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse duhet të përpiqen fort të forcojnë shenjtërinë e shtëpisë duke siguruar që të gjitha aktivitetet e Kishës të mbështesin jetën e individëve dhe të familjeve. Udhëheqësit e Kishës duhet të jenë të kujdesshëm që të mos i mbingarkojnë familjet me përgjegjësi të tepërta Kishë. Prindërit dhe udhëheqësit e Kishës punojnë së bashku për të ndihmuar familjet dhe individët që të kthehen tek Ati ynë në Qiell duke ndjekur Jezu Krishtin.

#### 1.4.1 Forcimi i Shtëpisë

Pasuesit e Krishtit ftohen që të “mblidhen”, “të qëndrojnë në vende të shenjta” dhe të “mos lëviz[in]” (DeB 45:32; 87:8; 101:22; shih edhe 2 Kronikave 35:5; Mateu 24:15). Këto vende të shenjta përfshijnë tempujt, shtëpitë dhe ndërtesat kish-tare. Prania e Shpirtit dhe sjellja e njerëzve që janë brenda këtyre strukturave fizike, janë çfarë i bëjnë ato “vende të shenjta”.

Kudo që të jetojnë anëtarët e Kishës, ata duhet të krijojnë një shtëpi ku Shpirti të jetë i pranishëm. Të gjithë anëtarët e Kishës mund të bëjnë përpjekje për të siguruar që vendi i tyre i banimit të sigurojë një vend shenjtërie nga bota. Çdo shtëpi në Kishë, e madhe apo e vogël, mund të jetë një “shtëpi lutjeje, një shtëpi agjërimi, një shtëpi besimi, një shtëpi mësimi, një shtëpi lavdie, një shtëpi rregulli, një shtëpi [e] Perëndisë” (DeB 88:119). Anëtarët e Kishës mund të ftojnë Shpirtin në shtëpitë e tyre me anë të mjeteve të thjeshta të tilla si zbavitje të dobishme, muzikë e mirë dhe vepra arti frymëzuese (për shembull, një pikturë e Shpëtimtarit ose e një tempulli).

Një shtëpi, me prindër të dashur dhe besnikë, është mjedisi ku përmbushen më me efektshmëri nevojat shpirtërore dhe fizike të fëmijëve. Një shtëpi e përqendruar tek Krishti, iu ofron të rriturve dhe fëmijëve një vend mbrojtjeje kundër mëkatit, strehë nga bota, shërim nga dhembje emocionale dhe të tjera, si dhe dashuri të angazhuar e të çiltër.

Prindërit janë urdhëruar gjithmonë që t’i rrisin fëmijët e tyre “në disiplinë dhe në këshillë të Zotit” (Efesianëve 6:4; Enosi 1:1) dhe “në dritë e të vërtetë” (DeB 93:40). Presidenca e Parë shpalli:

“Ne u kërkojmë prindërve të përkushtojnë përpjekjet e tyre më të mira për të mësuar dhe rritur fëmijët e tyre në parimet e ungjillit të cilat do t’i mbajnë ata pranë Kishës. Shtëpia është baza e një jete të drejtë dhe asnjë instrument tjetër nuk mund të zerë vendin e saj ose të përmbushë funksionet thelbësore të saj në çuarjen përpara të kësaj përgjegjësie të dhënë nga Perëndia.

Ne i këshillojmë prindërit dhe fëmijët t’i japin përparësinë më të lartë lutjes familjare, mbrëmjes familjare, studimit e udhëzimit të ungjillit dhe aktiviteteve të dobishme familjare. Sado të denja dhe të përshtatshme qofshin kërkesat ose aktivitetet e tjera, ato nuk duhet të lejohen të zëvendësojnë detyrat e caktuara hyjnisht që vetëm prindërit dhe familjet mund t’i kryejnë ashtu si duhet” (First Presidency letter, 11 shkurt 1999).

Prindërit kanë përgjegjësinë parësore që t’i ndihmojnë fëmijët e tyre të njohin Atin Qiellor dhe

Birin e Tij, Jezu Krishtin (shih Gjoni 17:3). Etërit dhe nënat shenjtore të ditëve të mëvonshme janë urdhëruar t’u mësojnë fëmijëve të tyre doktrinën e ungjillit, ordinancat, besëlidhjet dhe mënyrat e të jetuarit drejtësisht (shih DeB 68:25–28). Fëmijët që rriten dhe mësohen në këtë mënyrë, ka më shumë gjasa që të jenë të përgatitur në moshën e përshtatshme për të marrë ordinancat e priftërisë dhe për të bërë e mbajtur besëlidhje me Perëndinë.

Forcimi i familjeve është qendra e vëmendjes së programeve të frymëzuara të Kishës, të tilla si mësimi i shtëpisë (shih DeB 20:47, 51), vizita mësimore dhe mbrëmja familjare. Si në të gjitha gjërat, Jezusi dha shembullin e hyrjes nëpër shtëpi për të dhënë shërbesë, mësim dhe për të bekuar (shih Mateu 8:14–15; 9:10–13; 26:6; Marku 5:35–43; Lluka 10:38–42; 19:1–9).

#### 1.4.2 Mbrëmja Familjare

Profetët e ditëve të mëvonshme i kanë këshilluar prindërit që të mbajnë një mbrëmje familjare javore për t’u mësuar fëmijëve të tyre ungjillin, për të dhënë dëshmi për vërtetësinë e tij dhe për të forcuar unitetin familjar. Udhëheqësit e kuneve dhe të lagjeve duhet t’i mbajnë të lira mbrëmjet e së hënës nga të gjitha mbledhjet dhe aktivitetet e Kishës që të mund të mbahen mbrëmjet familjare.

Mbrëmja familjare mund të përfshijë lutje familjare, udhëzim për ungjillin, ndarje dëshmie, himne dhe këngë të Fillores dhe aktivitete të dobishme çlodhëse. (Për informacion mbi përdorimin e muzikës në shtëpi, shih 14.8.) Si pjesë e mbrëmjes familjare, ose veçmas, prindërit gjithashtu, mund të mbledhin një këshill familjar të herëpashershëm për të vendosur synime, për të zgjidhur probleme, për të bashkërenduar programe, si dhe për t’u dhënë mbështetje e forcë pjesëtarëve të familjes.

Mbrëmja familjare është një kohë e shenjtë dhe private familjare nën drejtimin e prindërve. Udhëheqësit e priftërisë nuk duhet të japin udhëzime se çfarë duhet të bëjnë familjet gjatë kësaj kohe.

#### 1.4.3 Forcimi i Individëve

Udhëheqësit e Kishës duhet t’u kushtojnë vëmendje të veçantë individëve që aktualisht nuk gëzojnë mbështetjen e një familjeje me anëtarë të fortë të Kishës. Këta anëtarë mund të përfshijnë fëmijë dhe të rinj, prindërit e të cilëve nuk janë anëtarë të Kishës, individë të tjerë në familje pjesërisht anëtare dhe të rritur beqarë të të gjitha moshave. Ata janë anëtarë të besëlidhur të familjes së përjetshme të Perëndisë, që Ai i do thëllësisht. Këtyre individëve duhet t’u jepen mundësi për

shërbim në Kishë. Kisha mund të sigurojë marrëdhënie shoqërore dhe shoqërim të dobishëm, që këta anëtarë nuk mund ta gjejnë askund tjetër.

Çdo anëtar i Kishës është po aq i çmuar sa cilido tjetër. Plani i përjetshëm i Perëndisë siguron që të gjithë fëmijët e Tij besnikë të marrin çdo bekim të jetës së përjetshme, të ekzaltuar në familje përgjithmonë.

---

## 2. Parimet e Priftërisë

<b>2.1 Autoriteti i Priftërisë</b> .....	<b>8</b>	<b>2.4 Përdorimi i Autoritetit të Priftërisë</b> .....	<b>10</b>
2.1.1 Çelësat e Priftërisë .....	8	2.4.1 Marrja e Autoritetit .....	10
2.1.2 Ordinancat .....	9	2.4.2 Delegimi i Autoritetit .....	10
2.1.3 Besëlidhjet .....	9	2.4.3 Ushtrimi i Autoritetit të Priftërisë me Drejtësi .....	10
<b>2.2 Qëllimi i Kishës</b> .....	<b>9</b>	2.4.4 Këshillat Kryesuese .....	10
<b>2.3 Priftëria dhe Familja</b> .....	<b>9</b>	2.4.5 Lartësimi i Thirrjeve të Priftërisë .....	10

## 2. Parimet e Priftërisë

Priftëria është fuqia dhe autoriteti i Perëndisë. Ajo ka ekzistuar gjithmonë dhe do të vazhdojë të ekzistojë pa fund (shih Alma 13:7–8; DeB 84:17–18). Me anë të priftërisë, Perëndia krijoi dhe qeveris qiejt dhe tokën. Me anë të kësaj fuqie, Ai ekzalton fëmijët e Tij të bindur, duke bërë të ndodhë “pavdekësia dhe jeta e përvetshme e njeriut” (Moisiu 1:39; shih edhe DeB 84:35–38).

Në jetën në vdekshmëri, priftëria është fuqia dhe autoriteti që Perëndia i jep njeriut për të vepruar në të gjitha gjërat e domosdoshme për shpëtimin e fëmijëve të Perëndisë. Bekimet e priftërisë janë të disponueshme për të gjithë ata që marrin ungjillin.

Pjesë të rëndësishme shkrimesh të shenjta mbi priftërinë që t’i studiojnë udhëheqësit, përfshijnë Alma 13 dhe Doktrina e Besëlidhje 13, 20, 84, 107, 121 dhe 124.

### 2.1 Autoriteti i Priftërisë

Priftëria ndahet në dy pjesë: Priftëria Aarone dhe Priftëria Melkizedeke.

Priftëria Aarone është priftëria më e vogël dhe “një shtesë e . . . Priftërisë Melkizedeke” (shih DeB 107:13–14). Ajo quhet Priftëria Aarone, sepse iu dha vëllait të Moisiut, Aaronit, dhe bijve të Aaronit.

Priftëria Aarone përfshin çelësat e shërbesës së engjëjve, ungjillin e pendimit e të pagëzimit me anë të zhytjes për heqjen e mëkateve (shih DeB 13:1; 84:26–27; 107:20). Ata që mbajnë Priftërinë Aarone, mund të autorizohen të administrojnë “ordinancat e jashtme” të pagëzimit dhe të sakramentit (shih DeB 107:14). Peshkopi është presidenti i Priftërisë Aarone në lagje. Si pjesë e kësaj përgjegjësie, ai administron çështje tokësore të tilla si mirëqenia dhe financat në lagje (shih DeB 107:68).

Priftëria Melkizedeke është priftëria më e lartë ose më e madhe. Ajo është e pranishme dhe funksionale kudo që Kisha e Jezu Krishtit është mbi tokë në plotësinë e saj. Së pari, ajo quhet “Priftëria e Shenjtë, sipas Urdhrit të Birit të Perëndisë. Por për shkak të respektit ose nderimit për emrin e Qenies Supreme, për të shmangur përsëritjen shumë të shpeshtë të emrit të tij, ata, kisha, në ditët e lashta, e quajtën atë priftëri sipas Melkizedekut ose Priftëria Melkizedeke” (DeB 107:3–4). Melkizedeku

ishite “një prift i lartë i shquar” (DeB 107:2), që jetoi gjatë kohës së Abrahamit.

Me anë të autoritetit të Priftërisë Melkizedeke, drejtuesit e Kishës e udhëheqin Kishën, drejtojnë predikimin e ungjillit në mbarë botën dhe administrojnë të gjithë punën shpirtërore të Kishës (shih DeB 84:19–22; 107:18). Presidenti i Kishës është prifti i lartë kryesues mbi Priftërinë Melkizedeke.

Kur një burrë merr Priftërinë Melkizedeke, ai bën besëlidhje që të jetë besnik, të lartësojë thirrjet e tij dhe të jetojë sipas çdo fjale të Perëndisë dhe shërbëtorëve të Tij (shih DeB 84:33–44).

#### 2.1.1 Çelësat e Priftërisë

Çelësat e priftërisë janë autoriteti që Perëndia u ka dhënë udhëheqësve të priftërisë për të drejtuar, kontrolluar dhe qeverisur përdorimin e priftërisë së Tij në tokë. Ushtrimi i autoritetit të priftërisë qeveriset nga ata që mbajnë çelësat e tij (shih DeB 65:2; 81:2; 124:123). Ata që mbajnë çelësat e priftërisë, kanë të drejtën të kryesojnë dhe drejtojnë Kishën brenda një juridiksioni.

Jezu Krishti mban të gjithë çelësat e priftërisë që i përkasin Kishës së Tij. Ai i ka dhënë secilit prej Apostujve të Tij të gjithë çelësat që i përkasin mbretërisë së Perëndisë në tokë. Apostulli më i vjetër i gjallë, Presidenti i Kishës, është i vetmi person në tokë i autorizuar të ushtrojë të gjithë çelësat e priftërisë (shih DeB 43:1–4; 81:2; 107:64–67, 91–92; 132:7).

Të Shtatëdhjetët veprojnë me caktim dhe me delegim të autoritetit nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve. Presidentët e Zonave caktohen të administrojnë zonat nën autorizimin e Presidencës së Parë dhe të Të Dymbëdhjetëve. Presidenca e Të Shtatëdhjetëve veçohet dhe i jepen çelësat për të kryesuar mbi Kuorumet e Të Shtatëdhjetëve.

Presidenti i Kishës iu delegon çelësa priftërie udhëheqësve të tjerë të priftërisë që ata të mund të kryesojnë në fushat e tyre të përgjegjësisë. Çelësat e priftërisë iu jepen presidentëve të tempujve, të misioneve, të kunjeve dhe të distrikteve; peshkopëve; presidentëve të degëve; dhe presidentëve të kuorumeve. Ky autoritet kryesues është i vlefshëm vetëm për përgjegjësitë e përcaktuara dhe brenda juridiksionit gjeografik të thirrjes së secilit udhëheqës. Kur udhëheqësit e priftërisë lirohen nga thirrjet e tyre, ata nuk i mbajnë më çelësat përkatës.

Këshilltarët e udhëheqësve të priftërisë nuk marrin çelësa. Ata veçohen dhe funksionojnë në thirrjet e tyre me anë të caktimit dhe autoritetit të deleguar.

Të gjitha organizatat ndihmëse të lagjes e të kunjtit veprojnë nën drejtimin e peshkopit ose të presidentit të kunjtit, i cili mban çelësat për të kryesuar. Presidentët e organizatave ndihmëse dhe këshilltarët e tyre nuk marrin çelësa. Ata marrin autoritet të deleguar për të funksionuar në thirrjet e tyre.

### 2.1.2 Ordinancat

Autoriteti i priftërisë kërkohet për të kryer ordinancat e ungjillit. Një ordinancë është një veprim i shenjtë fizik me kuptim simbolik, i tillë si pagëzimi, konfirmimi ose sakramenti. Secila ordinancë hap derën për bekime të mëdha shpirtërore. Simbolika ndihmon pjesëmarrësit të kujtojnë dashurinë e Atit, Shlyerjen e Birit dhe ndikimin e Frymës së Shenjtë.

Ordinancat kanë qenë gjithmonë pjesë e ungjillit të Jezu Krishtit. Pagëzimi, për shembull, u themelua në kohën e Adamit e të Evës dhe praktikohet në Kishën e Zotit sot. Anëtarët e Kishës urdhërohen të mblidhen shpesh së bashku për të marrë sakramentin që të kujtojnë gjithmonë Shpëtimtarin dhe të përtërijnë besëlidhjet dhe bekimet e pagëzimit (shih Moroni 6:6; DeB 59:8–9).

Disa ordinanca kërkohen për ekzaltimin në mbretërinë çelestiale për të gjithë njerëzit e përgjegjshëm. Këto ordinanca përfshijnë pagëzimin, konfirmimin, shugurimin në Priftërinë Melkizede (për burrat), indaumentin në tempull dhe vulosjen në tempull. Anëtarët e gjallë të Kishës i marrin vetë këto ordinanca shpëtuëse dhe ekzaltuese. Njerëzit e vdekur mund t'i marrin ato me mëkëmbës. Ordinancat me mëkëmbës hyjnë në fuqi vetëm kur personat e vdekur, për të cilët u kryen ordinancat, i pranojnë ato në botën e shpirtave dhe i nderojnë besëlidhjet e lidhura me to.

Për informacion të veçantë mbi kryerjen e ordinancave dhe mbi marrjen e autorizimeve të nevojshme, shih kapitullin 20.

### 2.1.3 Besëlidhjet

Të gjitha ordinancat e domosdoshme për shpëtim dhe ekzaltim, shoqërohen nga besëlidhje me Perëndinë. Një besëlidhje është një premtim i shenjtë dhe i qëndrueshëm midis Zotit dhe fëmijëve të Tij. Perëndia jep kushte për besëlidhjen dhe fëmijët e Tij bien dakord të pajtohen me ato kushte. Perëndia premtim bekime që janë të

kushtëzuara nga përmbushja me besnikëri e besëlidhjes prej personit.

Kur anëtarët e Kishës i nderojnë dhe i mbajnë besëlidhjet e tyre, ata bekohen shumë në jetën në vdekshmëri dhe fitojnë të drejtën për ekzaltim (shih Eksodi 19:3–5; Gjykatësit 2:1; 3 Nefi 20:25–27; Moroni 10:33; DeB 42:78; 97:8).

Për të përgatitur një individ për pjesëmarrje në një ordinancë, prindërit, pjesëtarë të tjerë të familjes, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse, si dhe mësuesit, sigurojnë që personi t'i kuptojë besëlidhjet që ai ose ajo do të bëjë (shih Mosia 18:8–11). Pas ordinancës, ata e ndihmojnë atë t'i mbajë ato besëlidhje (shih Mosia 18:23–26).

## 2.2 Qëllimi i Kishës

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme u organizua nga Perëndia për të ndihmuar në veprën e Tij, që të bëjë të ndodhë shpëtimi dhe ekzaltimi i fëmijëve të Tij. Kisha i fton të gjithë që të "[vijnë] te Krishti dhe [të përsosen] në të" (Moroni 10:32; shih edhe DeB 20:59). Ftesa për të ardhur te Krishti u përket të gjithëve që kanë jetuar ose do të jetojnë ndonjëherë mbi tokë.

Kur individët marrin ordinancat e pagëzimit dhe të konfirmimit, ata bëhen anëtarë të Kishës. Kisha i mbështet ata dhe familjet e tyre duke shërbyer si "strehim nga stuhia" e ndikimeve dhe e ligësisë së botës (DeB 115:6). Kisha siguron mundësi për shërbim, bekim dhe rritje personale. Programet dhe aktivitetet e Kishës mbështesin e forcojnë individët dhe familjet.

Në përmbushje të qëllimit të saj për të ndihmuar individët dhe familjet që të kualifikohen për ekzaltim, Kisha përqendrohet në përgjegjësi të caktuara hyjnisht. Këto përfshijnë ndihmën për anëtarët që të jetojnë ungjillin e Jezu Krishtit, mbledhjen e Izraelit nëpërmjet punës misionare, përkujdesjes për të varfrit e nevojtarët dhe mundësimin e shpëtimit për të vdekurit duke ndërtuar tempuj dhe duke kryer ordinanca mëkëmbëse.

## 2.3 Priftëria dhe Familja

Secili bashkëshort dhe baba në Kishë duhet të përpiqet fort që të jetë i denjë për të mbajtur Priftërinë Melkizede. Me bashkëshorten e tij si një partnere të barabartë, ai kryeson në drejtësi dhe dashuri, duke shërbyer si udhëheqësi shpirtëror i familjes. Ai udhëheq familjen në lutje, studim të shkrimit të shenjtë dhe mbrëmje familjare të rregullta. Ai punon me bashkëshorten e tij për t'i mësuar fëmijët e tyre dhe për t'i ndihmuar ata të përgatiten që të marrin ordinancat e shpëtimit

(shih DeB 68:25–28). Ai jep bekime priftërie për drejtim, shërim dhe ngushëllim.

Shumë anëtarë nuk kanë mbajtur besnikë të Priftërisë Melkizedeke në shtëpitë e tyre. Udhëheqësit e Kishës duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë dashurisë dhe mbështetjes së këtyre anëtarëve përmes kujdesit të frymëzuar e vëzhgues, duke përfshirë mësimin e shtëpisë dhe vizitat mësimore.

---

## 2.4 Përdorimi i Autoritetit të Priftërisë

### 2.4.1 Marrja e Autoritetit

Për informacion mbi shugurimin e vëllezërve në detyra në priftëri, shih 20.7. Për informacion mbi procesin e thirrjes, mbështetjes dhe veçimit të anëtarëve për të shërbyer në thirrjet në Kishë, shih kapitullin 19.

### 2.4.2 Delegimi i Autoritetit

Udhëheqësit e priftërisë mund të delegojnë autoritet duke caktuar të tjerë që t'i ndihmojnë ata në përmbushjen e një thirrjeje. Për informacion mbi delegimin, shih 3.3.4.

### 2.4.3 Ushtrimi i Autoritetit të Priftërisë me Drejtësi

Priftëria duhet të përdoret për të bekuar jetën e të tjerëve. Udhëheqës efektivë të priftërisë kryesojnë me dashuri dhe mirësi. Ata nuk përpiqen të imponojnë vullnetin e tyre mbi të tjerët. Përkundrazi, ata këshillohen me të tjerët dhe përpiqen të arrijnë në një marrëveshje me anë të zbulësës. Zoti

ka thënë se fuqia e priftërisë nuk mund të përdoret përveçse me drejtësi (shih DeB 121:36). Përdorimi i duhur i priftërisë është me anë të bindjes, durimit, mirësjelljes, zemërbutësisë, dashurisë së sinqertë dhe mirësisë (shih DeB 121:36, 41–42). Nëse një burrë përpiqet të abuzojë me fuqinë e priftërisë, “qiejt tërhiqen; Shpirti i Zotit hidhërohet; dhe kur ai tërhiqet, Amen priftërisë ose autoritetit të atij njeriu” (DeB 121:37).

### 2.4.4 Këshillat Kryesuese

Këshillat sigurojnë një mjet që udhëheqësit të mblidhen së bashku në unitet e besim për të kërkuar bashkërisht vullnetin e Zotit. Këshillat gjithashtu sigurojnë një mundësi për të bashkërenduar punën e kuorumeve dhe të organizatave ndihmëse. Shembuj të këshillave kryesuese në nivel vendor janë presidencat e kunjeve, peshkopatat dhe komitetet ekzekutive të priftërisë. Për informacion se si funksionojnë këshillat, shih 4.1.

### 2.4.5 Lartësimi i Thirrjeve të Priftërisë

Mbajtësit e Priftërisë lartësojnë thirrjet e tyre kur japin shërbim në shtëpitë e tyre dhe ndaj shenjtorëve të tjerë dhe kur përmbushin me ndër-gjegje përgjegjësitë e caktuara. Zoti ka këshilluar: “Çdo njeri duhet ta mësojë detyrën e tij dhe të veprojë në thirrjen që është caktuar, gjithë zell” (DeB 107:99). Mbajtësit e priftërisë i lartësojnë thirrjet e tyre kur shërbejnë me zell, japin mësim me besim dhe dëshmi, si dhe kur ngrenë, forcojnë dhe edukojnë bindje të drejtësisë në jetën e atyre për të cilët kanë përgjegjësi.

## 3. Udhëheqja në Kishën e Jezu Krishtit

<b>3.1 Mënyra e Udhëheqjes e Shpëtimtarit.....</b>	<b>12</b>	<b>3.3.4 Delegoni Përgjegjësi dhe Siguroni Përgjegjshmëri .....</b>	<b>13</b>
<b>3.2 Parimet e Udhëheqjes së Ungjillit.....</b>	<b>12</b>	<b>3.3.5 Paralajmëroni kundër Mëkatit, por Duajeni Mëkatarin.....</b>	<b>13</b>
3.2.1 Përgatituni Shpirtërisht.....	12	<b>3.3.6 Inkurajoni Nderimin.....</b>	<b>14</b>
3.2.2 Merrni Pjesë në Këshilla.....	12	<b>3.3.7 Përgatisni Rende Dite me Shkrim për Mbledhjet .....</b>	<b>14</b>
3.2.3 Shërbejuni të Tjerëve.....	12	<b>3.3.8 Planifikoni me Qëllim.....</b>	<b>14</b>
3.2.4 Jepni Mësim Ungjillin e Jezu Krishtit.....	12	<b>3.3.9 Përdorni Burime të Kishës për të Mësuar Detyrat .....</b>	<b>14</b>
3.2.5 Administroni Priftërinë ose Organizatat Ndihmëse .....	13	<b>3.4 Qëllimet e Udhëheqjes.....</b>	<b>14</b>
<b>3.3 Udhëzime të Mëtejshme për Udhëheqësit.....</b>	<b>13</b>		
3.3.1 Përfaqësoni Zotin dhe Kishën e Tij.....	13		
3.3.2 Ndërtoni Unitet dhe Harmoni.....	13		
3.3.3 Përgatisni të Tjerë që të Jenë Udhëheqës dhe Mësues .....	13		

## 3. Udhëheqja në Kishën e Jezu Krishtit

### 3.1 Mënyra e Udhëheqjes e Shpëtimtarit

Të gjithë udhëheqësit e Kishës thirren të ndihmojnë njerëzit e tjerë të bëhen “pasues të vërtetë . . . të Jezu Krisht[it]” (Moroni 7:48). Për ta bërë këtë, udhëheqësit së pari përpiqen fort të jenë dishepuj besnikë të Shpëtimtarit, duke jetuar çdo ditë në mënyrë të tillë që të mund të kthehen për të jetuar në prani të Perëndisë. Atëherë ata mund të ndihmojnë të tjerët që të zhvillojnë dëshmi të forta dhe t’u afrohen Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit. Programet dhe aktivitetet e Kishës ndihmojnë për t’i arritur këto qëllime.

Udhëheqësit mund t’u mësojnë më së miri të tjerëve se si të jenë “pasues të vërtetë” me anë të shembullit të tyre personal. Ky model – të jesh një dishepull besnik në mënyrë që të ndihmosh të tjerët të bëhen dishepuj besnikë – është qëllimi pas çdo thirrjeje në Kishë.

Kur udhëheqësit shërbejnë sipas këtij modeli, ata ndihmojnë anëtarët e Kishës që të dëshirojnë të jenë të denjë për martesën në tempull dhe bekimet e një familjeje të përjetshme.

### 3.2 Parimet e Udhëheqjes së Ungjillit

#### 3.2.1 Përgatituni Shpirtërisht

Shpëtimtari e urdhëroi Pjetrin: “Kur të jesh kthyer, forco vëllezërit e tu” (Lluka 22:32). Kur udhëheqësit kthehen në besim dhe rriten shpirtërisht, ata mund t’i ndihmojnë të tjerët që të kthehen në besim dhe të rriten shpirtërisht.

Udhëheqësit përgatiten shpirtërisht kur mbajnë urdhërimet, studiojnë shkrimet e shenja dhe mësimet e profetëve të ditëve të mëvonshme, luten, agjërojnë dhe e përuhin veten përpara Zotit. Me këtë përgatitje, ata janë në gjendje të marrin frymëzim që t’i udhëheqë ata në jetën e tyre personale, në përgjegjësitë e tyre familjare dhe në thirrjet e tyre.

#### 3.2.2 Merrni Pjesë në Këshilla

Në këshilla, udhëheqësit mbledhen nën drejtimin e udhëheqësve kryesues që të diskutojnë mënyra për të ndihmuar individët dhe familjet. Të udhëhequr nga Fryma e Shenjtë, ata punojnë së bashku për të përcaktuar mënyra efektive që t’u shërbejnë anëtarëve të organizatave të tyre. Disa shembuj të këshillave në Kishë janë këshillat e lagjeve, këshillat e kunjeve, peshkopatat,

si he presidencat e kuorumeve dhe të organizatave ndihmëse. Për udhëzim mbi pjesëmarrjen në këshilla, shih kapitullin 4.

#### 3.2.3 Shërbejuni të Tjerëve

Ashtu si Shpëtimtari, udhëheqësit përpiqen t’u shërbejnë individëve dhe familjeve, si shpirtërisht edhe fizikisht. Ata kujdesen për secilin person, jo thjesht për administrimin e një organizate. Ata ndihmojnë anëtarët e rinj, anëtarët më pak aktivë dhe ata që mund të jenë të vetmuar ose në nevojë për ngushëllim.

Qëllimi i shërbesës është të ndihmohen të tjerët që të bëhen pasues të vërtetë të Jezu Krishtit. Shërbesa për të tjerët përfshin:

- Të kujtuarit e emrave të tyre dhe njohjen me ta (shih Moroni 6:4).
- Dashjen e tyre pa i gjykuar (shih Gjoni 13:34–35).
- Kujdesin për ta dhe forcimin e besimit të tyre “një nga një”, ashtu si bëri Shpëtimtari (3 Nefi 11:15; 17:21).
- Krijimin e miqësisë së sinqertë me ta dhe takime në shtëpitë e tyre dhe vende të tjera (shih DeB 20:47).

#### 3.2.4 Jepni Mësim Ungjillin e Jezu Krishtit

Të gjithë udhëheqësit janë mësues. Mësimdhënia efektive frymëzon njerëzit që të forcojnë marrëdhënien e tyre me Perëndinë dhe që të jetojnë sipas parimeve të ungjillit.

Mësimdhënia më e fuqishme e udhëheqësve vjen nga shembulli i tyre personal. Udhëheqësit japin mësim gjithashtu duke ndarë dëshmitë e tyre dhe duke drejtuar diskutime me bazë doktrimore në mbledhjet e udhëheqjes, klasat dhe aktivitetet. Ata japin mësim nga shkrimet e shenja dhe fjalët e profetëve të ditëve të mëvonshme. Ata e dinë se “predikimi i fjalës . . . [ka] ndikim më të fuqishëm . . . sesa shpata, ose çdo gjë tjetër” (Alma 31:5).

Përveçse japin vetë mësim ungjillin, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse janë përgjegjës për cilësinë e të mësuarit dhe të mësimdhënies në organizatat e tyre. Ata sigurojnë që mësimdhënia në klasat e tyre të jetë kuptimplotë, lartësuese dhe e bazuar nga ana doktrimore.

Për udhëzim të mëtejshëm mbi mësimdhënien e ungjillit dhe mbikëqyrjen e përpjekjeve për të përmirësuar të mësuarit dhe mësimdhënien, shih 5.5.

### 3.2.5 Administroni Priftërinë ose Organizatat Ndhëmëse

Udhëheqësit janë më të efektshmit në përpjekjet e tyre për të forcuar të tjerët kur ndjekin udhëzimet e vendosura të Kishës. Udhëzimet për të administruar priftërinë dhe organizatat ndihmëse gjenden në kapitujt 7–12.

## 3.3 Udhëzime të Mëtejshme për Udhëheqësit

### 3.3.1 Përfaqësoni Zotin dhe Kishën e Tij

Për shkak se udhëheqësit e Kishës janë thirrur nga Zoti nëpërmjet shërbëtorëve të Tij të caktuar, ata përfaqësojnë Atë dhe Kishën e Tij. Si përfaqësues të Shpëtimtarit, udhëheqësit e shohin Atë si shembullin e tyre. Ai tha: “Çfarë lloj njerëzish duhet të jeni? Në të vërtetë, unë ju them juve, madje siç jam unë” (3 Nefi 27:27).

### 3.3.2 Ndërtoni Unitet dhe Harmoni

Zoti ka thënë: “Jini një; dhe nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë” (DeB 38:27). Udhëheqësit kryesues inkurajojnë unitetin duke kërkuar këshillë nga burrat dhe gratë që shërbejnë me ta. Anëtarët e presidencave dhe të këshillave ndihmojnë për të krijuar unitet duke ndarë ndjenjat dhe idetë e tyre të ndershme, duke komunikuar qartë dhe duke e dëgjuar njëri-tjetrin.

Kur udhëheqësit e organizatave të Kishës i ndjekin udhëheqësit e tyre të priftërisë dhe kur anëtarët e presidencave dhe të këshillave janë në unitet, ata mund të marrin udhëheqjen e Frymës së Shenjtë dhe të udhëheqin sipas vullnetit të Zotit.

### 3.3.3 Përgatisni të Tjerë që të Jenë Udhëheqës dhe Mësues

Në disa lagje, udhëheqësit mbështeten vazhdimisht tek një grup i vogël njerëzish që të japin shërbim tek priftëria dhe tek organizatat ndihmëse. Kjo mund t’i mbingarkojë ata pak besnikë dhe gjithashtu mund t’u rrëmbejë të tjerëve përvoja që do të mund t’i ndihmonin ata të mësonin e të rriteshin. Udhëheqësit efektivë u japin të gjithë anëtarëve mundësi për të shërbyer.

Ndërsa udhëheqësit kryesues, marrin parasysh me lutje anëtarë për të plotësuar poste udhëheqjeje dhe mësimdhënieje, ata duhet të kujtojnë se Zoti do t’i kualifikojë ata që thërret. Anëtarët nuk ka nevojë të kenë shumë përvojë përpara se të shërbejnë si mësues dhe udhëheqës. Ata mund të mësojnë nga përvoja, duke ushtruar besim e duke punuar me zell dhe duke marrë udhëzime mbështetje nga udhëheqësit e tyre.

Udhëheqësit kryesues kërkojnë mënyra për t’u dhënë mundësi shërbimi anëtarëve të rinj, anëtarëve që po kthehen në aktivitet në Kishë dhe të rinjve në moshë madhore beqarë. Anëtarët e rinj dhe të kthyer janë entuziastë për ungjillin e rivendosur dhe shpesh janë gati për mundësi për t’u shërbyer të tjerëve e për të mësuar për Kishën. Të rinjtë në moshë madhore beqarë kanë nevojë për mundësi për të kontribuar në punën e Zotit dhe për t’u rritur shpirtërisht.

Për informacion rreth rekomandimit të anëtarëve për të shërbyer në thirrje të Kishës, shih 19.1.1 dhe 19.1.2.

### 3.3.4 Delegoni Përgjegjësi dhe Siguroni Përgjegjshmëri

Udhëheqësit e veçantë nuk mundën dhe nuk duhet të bëjnë gjithçka vetë. Udhëheqësit që përpiqen të bëjnë së tepërmi sigurisht “do të rraskapite[n]” (Eksodi 18:18) dhe po kështu njerëzit të cilëve u shërbejnë. Udhëheqësit duhet t’u delegojnë mundësi shërbimi të tjerëve, të tillë si këshilltarët, nëpunësit dhe anëtarët e këshillave ose komiteteve.

Delegimi përfshin më tepër sesa t’i japësh dikujt një detyrë. Ai përfshin elementet që vijojnë:

- Shpjegimin e qëllimeve të detyrës, sugjerimin e mënyrave se si mund të kryhet dhe shpjegimin se kur duhet të përfundohet. Personi i caktuar duhet të kuptojë dhe ta pranojë përgjegjshmërinë për ta kryer detyrën dhe për të raportuar për të.
- Mbajtjen e një dokumenti me shkrim të detyrës dhe kontrollin e përparimit herë pas here.
- Respektimin e përpjekjeve të personit të caktuar për të zhvilluar plane dhe për të përmbushur detyrën. Udhëheqësit sigurojnë inkurajim dhe ndihmë sipas nevojës.
- Kërkesën ndaj personit që të raportojë mbi detyrën. Pasi të marrin raportin, udhëheqësit i pranojnë përpjekjet më të mira të personit dhe shprehin vlerësim për gjërat e mira që ka bërë ai.

### 3.3.5 Paralajmëroni kundër Mëkatit, por Duajeni Mëkatarin

Udhëheqësit duhet të jenë të palëkundur e të paepur në paralajmërimet e tyre kundër sjelljes mëkatore, por të mëshirshëm dhe të sjellshëm me ata që mëkatojnë. Ata i trajtojnë të tjerët ashtu si Shpëtimtari do t’i trajtonte ata. Bërja e kësaj i ndihmon anëtarët të ndiejnë dashurinë e Zotit për ta kur zbatojnë Shlyerjen në jetën e tyre.

### 3.3.6 Inkurajoni Nderimin

Nderimi është një qëndrim i qetë dhe paqësor adhurimi dhe respekti kundrejt Perëndisë. Ai të drejton tek të mësuarit e ungjillit dhe zbulesa personale. Nderimi i vërtetë i vjen nga brenda çdo individi.

Udhëheqësit mund të ndihmojnë për të kultivuar një mjedis nderues në grumbullimet e Kishës. Në mbledhjet e sakramentit, konferencat e kunjeve dhe mbledhje të ngjashme, udhëheqësit japin shembull të nderimit kur ulen në panel. Udhëheqësit gjithashtu inkurajojnë nderimin duke vendosur në program muzikë plot adhurim dhe biseda frymëzuese. Mësuesit mund ta inkurajojnë nderimin në klasa duke përgatitur mësim frymëzues, duke organizuar dhomat që përpara, duke përdorur figura e muzikë të përshtatshme dhe duke përshëndetur anëtarët e klasës në një mënyrë paqësore e të përzemërt. Shërbimet e adhurimit dhe orët mësimore në Kishë bëhen më të mira kur e gjithë lagjja bën përpjekje për të qenë nderuese.

### 3.3.7 Përgatisni Rende Dite me Shkrim për Mbledhjet

Rendet e ditës me shkrim mund të shërbejnë si udhërrëfyes për udhëheqësit kur diskutojnë mënyra se si t' u shërbejnë të tjerëve. Nëse rendet e ditës shpërndahen përpara mbledhjeve të këshillave ose atyre planifikuese, udhëheqësit do të jenë më të përgatitur për diskutimet. Udhëzime për përgatitjen e rendeve të ditës për mbledhje të ndryshme gjenden në kapitullin 4 dhe kapitujt 7–12.

### 3.3.8 Planifikoni me Qëllim

Udhëheqësit planifikojnë aktivitete, mësim dhe përpjekje të tjera për të bekuar jetën e anëtarëve të lagjes. Ata gjithmonë planifikojnë me një qëllim në mendje, që përpjekjet e tyre të japin dobi për ata të cilëve u shërbejnë. Për planifikimin e aktiviteteve, udhëheqësit ndjekin parimet që gjenden në 13.1 dhe 13.2. Për planifikimin e trajnimeve dhe mësimdhënies së ungjillit, ata ndjekin parimet që gjenden në 5.5.

Udhëheqësit bëjnë gjithashtu plane afatgjata për organizatat e tyre. Kjo përfshin mbajtjen e një kalendari vjetor, vendosjen e synimeve dhe vlerësimin periodik të përparimit në arritjen e atyre synimeve.

Me ndihmën e sekretarëve, udhëheqësit mbajnë një dokument me shkrim të planeve të tyre dhe ndjekin përparimin për plotësimin e detyrave. Pasi të kryejnë planet e tyre, ata vlerësojnë se sa mirë i përmbushën qëllimet e tyre këto plane. Ky vlerësim ndihmon për planifikimin në të ardhmen.

### 3.3.9 Përdorni Burime të Kishës për të Mësuar Detyrat

Udhëheqësit përdorin burimet e mëposhtme për t' i ndihmuar ata që të mësojnë dhe të përmbushin detyrat e tyre:

- Këtë manual. Presidencat e kunjeve dhe peshkopatat duhet të njihen me të gjithë këtë manual. Udhëheqës të tjerë duhet të njihen me kapitujt 1–6, kapitujt mbi organizatat e tyre dhe çfarëdo informacion tjetër që lidhet me përgjegjësitë e tyre. Manuali mëson parimet dhe praktikat që mund t' i ndihmojnë ata të shërbejnë me efektshmëri.
- Raportet. Nëpunësit dhe sekretarët u japin udhëheqësve raporte që tregojnë përparimin e individëve dhe të grupeve. Ky informacion i ndihmon udhëheqësit të kuptojnë se cilët njerëz dhe organizata kanë nevojë për vëmendjen e tyre të veçantë.
- Udhëzim nga udhëheqësit vendorë. Menjëherë pasi të mbështetet, çdo udhëheqës i ri duhet të kryejë një sesion trajnimi mbi thirrjen. Udhëheqësit që bëjnë sesionin e trajnimit, vazhdojnë të sigurojnë udhëzim dhe mbështetje me anë të mbledhjeve të udhëheqjes dhe komunikimit personal.
- Materiale të Kishës për trajnim. Këto materiale janë të disponueshme në seksionin Serving in the Church [Shërbimi në Kishë] të LDS.org ose nga selia e Kishës, ose zyra administruese e caktuar.
- Revista të Kishës dhe botime të tjera të Kishës.

## 3.4 Qëllimet e Udhëheqjes

Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve kanë treguar qëllimet vijuese që udhëheqësit t' i mbajnë në mendje ndërsa lartësojnë thirrjet e tyre.

Udhëheqësit inkurajojnë çdo anëtar që të marrë të gjitha ordinancat thelbësore të priftërisë, të mbajë besëlidhjet e shoqëruara me to dhe të kualifikohet për ekzaltimin dhe jetën e përjetshme. Udhëheqësit e Kishës drejtojnë përpjekjet e kuorumeve të priftërisë, të organizatave ndihmëse dhe të këshillave të kunjeve e të lagjeve për të ndihmuar që të jepen rezultatet vijuese:

**Familjet:** Jepni mësim epërsinë e shtëpisë e të familjes si njësi organizative bazë e Kishës. Theksoni rolin e priftërisë më të lartë për të ndihmuar individët dhe familjet që të kualifikohen për ekzaltim (shih DeB 84:19–22). Nxisni çdo pjesëtar të familjes – prindërit dhe fëmijët – që të studiojnë shkrimet e shenjta, të luten rregullisht dhe të jetojnë ungjillin e Jezu Krishtit.

**Të Rriturit:** Inkurajoni çdo të rritur që të jetë i denjë për të marrë ordinancat e tempullit. Jepuni mësim të gjithë të rriturve që të identifikojnë paraardhësit e tyre dhe të kryejnë ordinanca mëkëmbëse në tempull për ta.

**Rinia:** Ndhmoni çdo të ri që të përgatitet për të marrë Priftërinë Melkizedeke, për të marrë ordinancat e tempullit dhe për të qenë i denjë që të shërbejë një mision kohëplotë. Ndhmoni çdo të re që të përgatitet që të jetë e denjë për të bërë dhe mbajtur besëlidhjet e shenjta dhe për të marrë ordinancat e tempullit. Forcojeni rininë nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete kuptimplote.

**Të Gjithë Anëtarët:** Ndhmoni udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse, këshillat e lagjeve, misionarët e lagjeve dhe kohëplotë, si dhe anëtarët që të punojnë në bashkëveprim në përpjekje të baraspeshuar për të shpëtuar individët, për të forcuar familjet dhe njësitë e Kishës, për të rritur aktivitetin e priftërisë dhe për të mbledhur Izraelin me anë të kthimit në besim, mbajtjes dhe aktivizimit. Mësojini anëtarët të sigurojnë për vete e familjet e tyre dhe për të ndihmuar të varfrit e nevojtarët sipas mënyrës së Zotit.



---

## 4. Këshilli i Lagjes

4.1 Këshillat në Kishë.....	18	4.6 Mbledhjet e Këshillit të Lagjes .....	19
4.2 Peshkopata .....	18	4.6.1 Parimet Udhëzuese .....	19
4.3 Komiteti Ekzekutiv i Priftërisë.....	18	4.6.2 Model Rendi Dite.....	20
4.4 Këshilli i Lagjes.....	18	4.6.3 Zbatimi i një Radhe Veprimi .....	20
4.5 Puna e Këshillit të Lagjes .....	18	4.6.4 Përgjegjësitë e Nëpunësit të Lagjes.....	21
4.5.1 Ndhmon të Përparojë Çdo Individ .....	18	4.6.5 Përgjegjësitë e Sekretarit Ekzekutiv .....	21
4.5.2 Ndhmon të Forcohet Lagjja.....	19		

---

## 4. Këshilli i Lagjes

---

### 4.1 Këshillat në Kishë

Kisha e Zotit qeveriset me anë të këshillave në nivel të përgjithshëm, të zonës, të kunjit dhe të lagjes. Këto këshilla janë themelore për rendin e Kishës.

Nën çelësat e udhëheqjes së priftërisë në çdo nivel, udhëheqësit këshillohen së bashku për përfitimin e individëve dhe të familjeve. Anëtarët e këshillit planifikojnë gjithashtu punën e Kishës lidhur me detyrat e tyre. Këshilla efektive i ftojnë anëtarët e këshillit të shprehen plotësisht dhe i bashkojnë përpjekjet e tyre në përgjigje të nevojave vetjake, familjare dhe të organizatave.

Si prifti i lartë kryesues i lagjes, peshkopi kryeson mbi tre këshillat e lidhura: peshkopata, komiteti ekzekutiv i priftërisë dhe këshilli i lagjes. Ky kapitull jep një shpjegim për secilin prej këtyre.

---

### 4.2 Peshkopata

Peshkopata ka përgjegjësi për të gjithë anëtarët, organizatat dhe aktivitetet e lagjes. Peshkopata zakonisht mblidhet të paktën çdo javë. Marrin pjesë nëpunësi i lagjes dhe sekretari ekzekutiv i lagjes. Për çështje të sugjeruara të rendit të ditës, shih 18.2.6.

Vendimet e peshkopit janë më të mirinformuara dhe zbatohen më mirë kur merren pas diskutimeve me këshilltarët e tij dhe, kur është me vend, me këshillin e lagjes. Në këto diskutime peshkopi nuk tregon informacion që duhet ta mbajë të fshehtë.

---

### 4.3 Komiteti Ekzekutiv i Priftërisë

Komiteti ekzekutiv i priftërisë i lagjes (KEP) përfshin peshkopatën, nëpunësin e lagjes, sekretarin ekzekutiv të lagjes, udhëheqësin e grupit të priftërinjve të lartë, presidentin e kuorumit të pleqve, udhëheqësin e misionit të lagjes dhe presidentin e Të Rinjve.

KEP-i mblidhet rregullisht për të trajtuar çështje të priftërisë. Në përgjithësi KEP-i nuk ka nevojë të trajtojë çështje që do të diskutohen nga këshilli i lagjes. Megjithatë, mund të jetë e dobishme për KEP-in që të shohë paraprakisht disa çështje që do të jenë në rendin e ditës të këshillit të lagjes. Për lehtësi, KEP-i mund të mblidhet pikërisht përpara mbledhjes së këshillit të lagjes.

Si të jetë e nevojshme, peshkopi mund të ftojë presidenten e Shoqatës së Ndhmës që të marrë pjesë në disa mbledhje të KEP-it të lagjes për të diskutuar çështje konfidenciale të mirëqenies dhe për të bashkërenduar detyrat e mësimit të shtëpisë e të vizitave mësimore.

---

### 4.4 Këshilli i Lagjes

Këshilli i lagjes përfshin peshkopatën, nëpunësin e lagjes, sekretarin ekzekutiv të lagjes, udhëheqësin e grupit të priftërinjve të lartë, presidentin e kuorumit të pleqve, udhëheqësin e misionit të lagjes dhe presidentët e Shoqatës së Ndhmës, të Të Rinjve, të Të Rejave, të Fillores dhe të Shkollës së Dielës.

Anëtarët e këshillit të lagjes përpiqen shumë t'i ndihmojnë individët që të ndërtojnë dëshmi, të marrin ordinancat shpëtuese, të mbajnë besëlidhjet dhe të bëhen pasues të përkushtuar të Jezu Krishtit (shih Moroni 6:4–5). Të gjithë anëtarët e këshillit të lagjes kanë një përgjegjësi të përgjithshme për mirëqenien e anëtarëve të lagjes. Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse kanë gjithashtu një përgjegjësi të veçantë që të vëzhgojnë dhe forcojnë çdo anëtar në organizatën e tyre.

Zakonisht, këshilli i plotë i lagjes trajton vetëm çështje që 1) do të kishin përfitim nga bashkërendimi mes organizatave, 2) do të kishin përfitim nga diskutimi dhe përpjekjet e bashkuara të këshillit, ose 3) përbëjnë shqetësim të përgjithshëm për lagjen si e tërë. Shumica e çështjeve që janë të veçanta për një organizatë priftërie ose ndihmëse duhet të trajtohen nga udhëheqësit në atë organizatë, jo nga i gjithë këshilli i lagjes. Për më tepër, anëtarë të veçantë të këshillit të lagjes mund t'i ngrenë veçmas peshkopit çështje delikate ose konfidenciale.

---

### 4.5 Puna e Këshillit të Lagjes

#### 4.5.1 Ndhmon të Përparojë Çdo Individ

Anëtarët e këshillit të lagjes e kryejnë shumicën e punës së tyre jashtë mbledhjeve të këshillit të lagjes. Ata punojnë me këshilltarët e tyre dhe me mësuesit e shtëpisë, mësueset vizitore e të tjerë për të ndihmuar dhe për t'u shërbyer njerëzve në organizatat e tyre dhe të tjerëve që kanë nevojë për ndihmë.

Anëtarët e këshillit të lagjes përpriqen shumë që të qëndrojnë në dijeni mbi nevojat, mirëqenien dhe përparimin shpirtëror të anëtarëve në organizatat e tyre. Ata gjithashtu qëndrojnë në dijeni mbi anëtarët që përballen me sfida të veçanta ose rrethana në ndryshim. Ky informacion i lejon që të forcojnë ata që kanë më shumë nevojë për ndihmën e tyre. Në të njëjtën kohë, ata respektojnë privatësinë vetjake dhe familjare. Vetëm peshkopi merret me çështje të denjësisë personale.

Burimet e mëposhtme mund t'i ndihmojnë anëtarët e këshillit të lagjes që të jenë në dijeni për përparimin e anëtarëve dhe të kërkuesve:

1. Raportet mbi pjesëmarrjen e anëtarit, të tillë si Raporti Tremujor i lagjes. Këto raporte përgatiten nga nëpunësi i lagjes. Ato japin informacion mbi aktivitetin në Kishë, statistikën mbi ordinancat [që kanë marrë ose jo anëtarët] dhe prirjet për individët, grup-moshat dhe të gjithë lagjen. Në lagje që përdorin program kompjuterik të Kishës për mbajtjen e dokumenteve, nëpunësi mund të sigurojë gjithashtu raporte të tjera që kanë informacion të dobishëm.
2. Raportet nga mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore.
3. Formulari i Përparimit të Anëtarit të Ri dhe të Kthyer në Aktivitet. Anëtarët e këshillit të lagjes e përdorin këtë formular për të planifikuar mënyra të veçanta për t'u dhënë mësim e për t'i forcuar anëtarët e rinj që nga koha e pagëzimit dhe e konfirmimit të tyre derisa të marrin indaumentin në tempull. Anëtarët e këshillit të lagjes mund ta përdorin gjithashtu këtë formular për të planifikuar se si t'i ndihmojnë anëtarët më pak aktivë që të përgatiten për të marrë ordinancat të cilat janë të përshtatshme për moshën e tyre, përfshirë ordinancat e tempullit.
4. Dokumenti i Përparimit. Misionarët kohëplotë e përdorin këtë formular për të shënuar përparimin e çdo kërkuesi. Misionarët ia tregojnë këtë informacion udhëheqësit të misionit të lagjes, i cili ia tregon këshillit të lagjes.

#### 4.5.2 Ndhmon të Forcohet Lagjja

Anëtarët e këshillit të lagjes punojnë së bashku për të ndërtuar forcë shpirtërore dhe unitet në lagje. Këshilli i lagjes gjithashtu mbikëqyr planifikimin e aktiviteteve për lagjen. Aktivitetet duhet të planifikohen që të përmbushin qëllime të përqendruara tek ungjilli. Për më shumë informacion mbi aktivitetet, shih kapitullin 13.

## 4.6 Mbledhjet e Këshillit të Lagjes

Këshilli i lagjes mbledhet rregullisht (të paktën çdo muaj). Mbledhja zakonisht zgjat 60 deri 90 minuta.

Peshkopi kryeson mbledhjen. Nëse mungon, ai mund të caktojë një këshilltar që të kryesojë. Megjithatë, vendimet kryesore nuk merren në mungesë të peshkopit.

Siç rekomandohet nga udhëheqësi i misionit të lagjes, peshkopi mund të ftojë herë pas here misionarë kohëplotë që të mblidhen me këshillin e lagjes.

### 4.6.1 Parimet Udhëzuese

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të lagjes me dy role: 1) si anëtarë të këshillit të lagjes, që ndihmojnë peshkopin të trajtojë nevojat e shqetësimet në lagje dhe të gjejë zgjidhje, si dhe 2) si përfaqësues të organizatave të tyre. Këta udhëheqës kërkojnë udhëheqjen e Frymës së Shenjtë ndërsa bashkohen me dashuri e shqetësim për ata të cilëve u shërbejnë.

Mbledhjet e këshillit të lagjes duhet të përqendrohen në çështje që do të forcojnë individët dhe familjet. Këshilli shpenzon kohë minimale për programim, planifikim të aktiviteteve dhe çështje të tjera administrative.

Gjatë mbledhjes, peshkopi shpjegon çdo çështje që trajtohet, por normalisht ai nuk vendos se si ta zgjidhë çështjen derisa të ketë dëgjuar diskutimin. Ai e inkurajon diskutimin pa e mbizotëruar atë. Ai bën pyetje dhe mund t'u kërkojë sugjerimet e tyre anëtarëve të veçantë të këshillit. Ai dëgjon me kujdes përpara se të marrë vendim. Këto diskutime duhet të inkurajojnë një mjedis frymëzimi.

Anëtarët e këshillit, inkurajohen të flasin ndershmërisht, si nga përvoja e tyre vetjake ashtu dhe nga pozicioni i tyre si udhëheqës organizate. Si burrat edhe gratë duhet të ndiejnë se komentet e tyre vlerësohen si pjesëmarrës të plotë. Peshkopi kërkon ide nga udhëheqëset e Shoqatës së Ndhmës, të Të Rejave dhe të Fillores për të gjitha çështjet e trajtuara nga këshilli i lagjes. Pikëpamja e grave nganjëherë është e ndryshme nga ajo e burrave dhe i shton këndvështrim thelbësor kuptueshmërisë dhe përgjigjes ndaj nevojave të anëtarëve.

Pas diskutimit të hapur, peshkopi mund të marrë një vendim ose mund të presë ta diskutojë çështjen më tej me këshilltarët e tij. Pasi ai të ketë marrë vendim, anëtarët e këshillit duhet ta mbështesin këtë me një qëndrim uniteti dhe harmonie.

Nëse anëtarët e këshillit kanë ndjenja të fuqishme të pavendosura për një vendim të rëndësishëm, peshkopi mund të presë për një mbledhje tjetër këshilli që ta trajtojë çështjen më tej dhe të kërkojë konfirmim shpirtëror dhe unitet.

Anëtarët e këshillit duhet të mbajnë të fshehtë çfarëdo informacion privat ose të ndjeshëm mbi anëtarët, familjet dhe temat e diskutuara.

#### 4.6.2 Model Rendi Dite

Nën drejtimin e peshkopit, sekretari ekzekutiv përgatit një rend dite për mbledhjen e këshillit të lagjes. Peshkopi fton anëtarët e këshillit që të kontaktojnë sekretarin ekzekutiv për të vendosur çështje për diskutim në rendin e ditës. Sekretari ekzekutiv gjithashtu mund të sugjerojë çështje për rend dite, përfshirë ato nga mbledhjet e mëparshme që mund të kenë nevojë për diskutim shtesë ose ndjekje të mëtejshme. Sekretari ekzekutiv mund të përgatisë gjithashtu një kalendar për ngjarjet e ardhshme të lagjes që ta këqyrin anëtarët e këshillit.

Një listë e çështjeve që mund të përfshihen në rendin e ditës, jepet më poshtë. Peshkopi nuk duhet të përpiqet t'i trajtojë të gjitha këto çështje në çdo mbledhje. Përkundrazi, ai vë përparësitë për rendin e ditës të çdo mbledhjeje që të trajtohen së pari çështjet më të rëndësishme. Në vend që të diskutohen shumë çështje në mënyrë sipërfaqësore, është më mirë të përqendrohen tek disa që do të bekojnë më së shumti individët dhe familjet. Peshkopi mbështetet tek frymëzimi për të ditur se cilat çështje kanë më shumë rëndësi në një kohë të caktuar.

1. Raporte të shkurtra nga detyrat prej mbledhjes së shkuar.
2. Mirëqenia shpirtërore dhe fizike. Diskutoni mirëqenien shpirtërore dhe fizike të individëve dhe familjeve të përzgjedhura. Bëni plane për t'i ndihmuar ata që të plotësojnë nevojat e tyre, përfshirë nevojat afatgjata. Diskutoni se si të forconi familjet. Për më shumë informacion, shih 6.2.2.
3. Puna misionare. Zhvilloni dhe këqyrni planin misionar të lagjes (shih 5.1.8). Duke përdorur Dokumentin e Përparimit, këqyrni kandidatët për pagëzim dhe kërkuesit që aktualisht po përparojnë. Peshkopi mund t'i kërkojë udhëheqësit të misionit të lagjes që ta udhëheqë këtë këqyrje. Për më shumë informacion, shih 5.1.2.
4. Mbatja e të kthyerve në besim. Këqyrni përparimin e çdo anëtarit të ri të renditur në formularin Përparimi i Anëtarit të Ri dhe të Kthyer në

Aktivitet; planifikoni mënyra për t'i ndihmuar ata që të vazhdojnë përparimin (shih 5.2.3).

5. Aktivizimi. Këqyrni përparimin dhe shoqërimin e anëtarëve më pak aktivë të renditur në formularin Përparimi i Anëtarit të Ri dhe të Kthyer në Aktivitet; planifikoni mënyra për t'i ndihmuar ata që të vazhdojnë përparimin (shih 5.3.2).
6. Tempulli dhe historia familjare. Këqyrni përparimin e anëtarëve individualisht që po përgatiten për të marrë ordinancat e tempullit. Ashtu si ta ndjejë nevojën peshkopi, diskutoni se si t'i inkurajoni anëtarët që të marrin pjesë më plotësisht në punën në tempull dhe të historisë familjare. Për më shumë informacion, shih 5.4.2.
7. Të mësuarit dhe mësimdhënia e ungjillit. Diskutoni se si ta përmirësoni të mësuarit dhe mësimdhënien e ungjillit në mbledhje të Kishës dhe në shtëpi (shih 5.5.2).
8. Raporte mbi punën e kuorumit të pleqve, grupit të priftërinjve të lartë dhe organizatave ndihmëse. Kjo pjesë e mbledhjes duhet të jetë e shkurtër që të mos tërheqë vëmendjen nga përqendrimi kryesor i këshillit tek individët.
9. Programimi dhe planifikimi i aktiviteteve për të ndihmuar që të plotësohen nevojat shpirtërore, fizike dhe shoqërore të anëtarëve të lagjes (shih kapitullin 13).
10. Fondi i Përhershëm Arsimor (atje ku programi është i miratuar). Këqyrni përparimin e pjesëmarrësve në program.
11. Udhëzim përmbyllës nga peshkopata.

#### 4.6.3 Zbatimi i një Radhe Veprimi

Këshilli i lagjes kërkon frymëzim për zhvillimin e një radhe veprimi për të bekuar jetën e anëtarëve. Përqendrimi i këshillit është që të ndihmojë njerëzit, jo të drejtojë programe.

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse përdorin mbledhjet e veta të udhëheqjes për të këqyruar vendimet e këshillit të lagjes dhe për të marrë ndihmën e udhëheqësve dhe mësuesve të tjerë në organizatën e tyre për të përmbushur detyrat e këshillit. Në mënyrë të ngjashme, udhëheqësi i misionit i lagjes mban një mbledhje bashkërendimi misionar me misionarët kohëplotë dhe misionarët e lagjes për të zbatuar vendimet e këshillit të lagjes. Kjo punë në organizata është një zgjerim i synimit dhe qëllimit të këshillit të lagjes.

Kur ndërmerin një radhë veprimi, anëtarët e këshillit duhet të jenë të kujdesshëm që të shmangin mbingarkesën e individëve dhe të familjeve

(shih Mosia 4:27; DeB 10:4). Përparësia e parë e çdo anëtari është familja e tij apo e saj. Këshilli i lagjes siguron një baraspeshë të përshtatshme mes detyrimeve familjare të anëtarit dhe përgjegjësive të tij apo të saj në Kishë.

Anëtarët e këshillit të lagjes vlerësojnë rregullisht çdo radhë veprimi dhe raportojnë mbi detyrat e tyre. Në shumicën e rasteve, përparimi do të kërkojë vëmendje të pandërprerë dhe detyra për ndjekje të mëtejshme.

#### 4.6.4 Përgjegjësitë e Nëpunësit të Lagjes

Nëpunësi i lagjes mban një dokument të detyrave dhe vendimeve të marra gjatë mbledhjeve të këshillit të lagjes. Ai siguron që informacioni i përdorur nga këshilli i lagjes të jetë i saktë dhe i përditësuar. Ai siguron kopjet më të fundit të formularit Përparimi i Anëtarit të Ri dhe të Kthyer në aktivitet. Ai gjithashtu siguron informacion statistikor përkatës nga programi kompjuterik i Kishës për mbajtjen e dokumenteve. Ai merr nismën që të vërë në dijeni peshkopatën dhe anëtarët e këshillit të lagjes mbi informacionin që gjen

në këto burime, në vend që të presë që ata t'ia kërkojnë atij.

Përgjegjësi të tjera të nëpunësit të lagjes janë përvijuar tek *Handbook 1 [Manuali 1]*, 13.4.2.

#### 4.6.5 Përgjegjësitë e Sekretarit Ekzekutiv

Sekretari ekzekutiv përgatit rendet e ditës për mbledhjet e këshillit të lagjes siç përvijohet tek 4.6.2. Peshkopi mund t'i kërkojë atij gjithashtu që të ndihmojë për ndjekjen e mëtejshme me anëtarët e këshillit të lagjes mbi detyrat e tyre. Përveç kësaj, peshkopi mund t'i kërkojë atij të marrë raporte nga anëtarët e këshillit të lagjes mbi gjendjen e kërkuesve, të anëtarëve të rinj, të anëtarëve që kthehen në aktivitet dhe mbi çështje të tjera.

Sekretari ekzekutiv mund të sigurojë vijueshmërinë mes këshillit të lagjes dhe komitetit ekzekutiv të priftërisë.

Përgjegjësi të tjera të sekretarit ekzekutiv të lagjes janë përvijuar tek *Handbook 1 [Manuali 1]*, 13.4.4.



## 5. Puna për Shpëtim në Lagje dhe Kuj

<b>5.1 Puna Misionare e Anëtarit</b> . . . . .	<b>24</b>	5.3.4 Misionarët Kohëplotë dhe Misionarët e Lagjes . . . . .	29
5.1.1 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij . . . . .	24	5.3.5 Klasa e Parimeve të Ungjillit . . . . .	29
5.1.2 Këshilli i Lagjes . . . . .	24	5.3.6 Udhëheqësit e Kujit . . . . .	29
5.1.3 Udhëheqësi i Misionit i Lagjes . . . . .	24	<b>5.4 Puna në Tempull dhe për Historinë Familjare</b> . . . . .	<b>30</b>
5.1.4 Misionarët e Lagjes . . . . .	25	5.4.1 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij . . . . .	30
5.1.5 Mbledhja e Bashkërendimit Misionar . . . . .	25	5.4.2 Këshilli i Lagjes . . . . .	30
5.1.6 Anëtarët dhe Misionarët Kohëplotë në Punë së Bashku . . . . .	25	5.4.3 Udhëheqësi i Grupit të Priftërinjve të Lartë . . . . .	31
5.1.7 Shërbimet e Pagëzimit dhe Konfirmimet . . . . .	25	5.4.4 Këshilluesit për Historinë Familjare . . . . .	31
5.1.8 Plani Misionar i Lagjes . . . . .	26	5.4.5 Klasat dhe Burimet për Punën në Tempull dhe për Historinë Familjare . . . . .	31
5.1.9 Udhëheqësit e Kujit . . . . .	26	5.4.6 Udhëheqësit e Kujit . . . . .	32
<b>5.2 Mbajtja e të Kthyerve në Besim</b> . . . . .	<b>26</b>	5.4.7 Burimet për Tempullin dhe për Historinë Familjare në Kuj . . . . .	32
5.2.1 Nevojat e Anëtarëve të Rinj . . . . .	26	<b>5.5 Mësimdhënia e Ungjillit</b> . . . . .	<b>32</b>
5.2.2 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij . . . . .	26	5.5.1 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij . . . . .	32
5.2.3 Këshilli i Lagjes . . . . .	27	5.5.2 Këshilli i Lagjes . . . . .	32
5.2.4 Udhëheqësit e Priftërisë dhe të Organizatave Ndhmëse . . . . .	27	5.5.3 Udhëheqësit e Priftërisë dhe të Organizatave Ndhmëse . . . . .	33
5.2.5 Mësuesit e Shtëpisë dhe Mësueset Vizitore . . . . .	28	5.5.4 Mësuesit dhe Udhëheqësit . . . . .	33
5.2.6 Misionarët e Lagjes dhe Misionarët Kohëplotë . . . . .	28	5.5.5 Presidenti i Shkollës të së Dielës i Lagjes dhe Këshilltarët e Tij . . . . .	34
5.2.7 Ndikimi i Anëtarëve të Tjerë të Lagjes . . . . .	28	5.5.6 Burime të Shtypura dhe në Internet për të Mësuarit dhe Mësimdhënie . . . . .	34
5.2.8 Klasa e Parimeve të Ungjillit . . . . .	28	5.5.7 Kursi mbi Mësimdhënien e Ungjillit . . . . .	34
5.2.9 Udhëheqësit e Kujit . . . . .	28	5.5.8 Presidenti i Kujit dhe Këshilltarët e Tij . . . . .	34
<b>5.3 Aktivizimi</b> . . . . .	<b>29</b>		
5.3.1 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij . . . . .	29		
5.3.2 Këshilli i Lagjes . . . . .	29		
5.3.3 Mësuesit e Shtëpisë dhe Mësueset Vizitore . . . . .	29		

## 5. Puna për Shpëtim në Lagje dhe Kunj

Anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit dërgohen “për të punuar në vreshtin e tij për shpëtimin e shpirtrave të njerëzve” (DeB 138:56). Kjo punë për shpëtim përfshin punën misionare të anëtarit, mbajtjen e të kthyerve në besim, aktivizimin e anëtarëve më pak aktivë, punën në tempull e për historinë familjare dhe mësimdhënien e ungjillit. Peshkopata drejton këtë punë në lagje, e ndihmuar nga anëtarë të tjerë të keshillit të lagjes.

Edhe pse peshkopi mban përgjegjësinë më të lartë në këto fusha, udhëheqësi i misionit i lagjes bashkërendon punën misionare të anëtarit, udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë bashkërendon punën në tempull dhe për historinë familjare dhe presidenti i Shkollës të së Dieles ndihmon udhëheqësit e tjerë të lagjes për përmirësimin e të mësuarit dhe mësimdhënies së ungjillit. Peshkopi mund të caktojë njërin prej keshilltarëve të tij që të bashkërendojë mbajtjen e të kthyerve në besim dhe tjetrin që të bashkërendojë aktivizimin. Secili udhëheqës i priftërisë apo i organizatave ndihmëse ndihmon për ta çuar më tej punën për shpëtim në organizatën e tij apo të saj.

### 5.1 Puna Misionare e Anëtarit

#### 5.1.1 Peshkopi dhe Keshilltarët e Tij

Peshkopi drejton keshillin e lagjes për përgatitjen dhe ndjekjen e një plani misionar të lagjes, siç përshkruhet në 5.1.8.

Peshkopi thërret dhe veçon një mbajtës të Priftërisë Melkizedeke që të shërbejë si udhëheqësi i misionit i lagjes. Peshkopi dhe keshilltarët e tij mund të thërrasin e të veçojnë anëtarë të tjerë që të shërbejnë si misionarë të lagjes.

Peshkopi dhe keshilltarët e tij i japin përparësi punës misionare të anëtarit. Ata i japin mësim rregullisht doktrinat e punës misionare. Ata i inkurajojnë anëtarët e lagjes për të punuar me misionarët kohëplotë që të gjejnë, t’u japin mësim dhe të pagëzojnë kërkues. Ata japin shembullin duke gjetur dhe përgatitur individë dhe familje që t’u japin mësim misionarët.

Peshkopi dhe keshilltarët e tij ndihmojnë misionarë kohëplotë të mundshëm, përfshirë motra dhe çifte, që të përgatiten për të shërbyer misione.

#### 5.1.2 Keshilli i Lagjes

Puna misionare e anëtarit është më efektive kur anëtarët e keshillit të lagjes përfshihen plotësisht në përpjekje misionare. Në kuorume dhe organizata ndihmëse, ata i inkurajojnë anëtarët të marrin pjesë në punën misionare në mënyrat e mëposhtme:

1. Gjejnë dhe përgatisin njerëz që të marrin mësim.
2. Ndihmojnë misionarët kur ata japin mësim (në shtëpitë e anëtarëve, nëse është e mundur).
3. Shoqërojnë kërkuesit.
4. Përgatiten vetë dhe përgatisin fëmijët e tyre që të shërbejnë si misionarë kohëplotë.

Në mbledhjet e keshillit të lagjes, anëtarët e keshillit zhvillojnë dhe këqyrin planin misionar të lagjes (shih 5.1.8). Ata këqyrin kandidatët për pagëzim, kërkues të tjerë dhe çështje të tjera nga Dokumenti i Përparimit i përgatitur nga misionarët kohëplotë. Ata bëjnë plane që të ndihmojnë të përparojë secili kërkues. Ata ofrojnë keshilla mbi mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore të mundshme për kërkuesit që po përgatiten të pagëzohen dhe të konfirmohen.

Siç rekomandohet nga udhëheqësi i misionit të lagjes, peshkopi mund të ftojë herë pas here misionarë kohëplotë që të mbledhen me keshillin e lagjes.

#### 5.1.3 Udhëheqësi i Misionit i Lagjes

Nën drejtimin e peshkopit, udhëheqësi i misionit i lagjes ka përgjegjësitë e mëposhtme:

Ai bashkërendon përpjekjet e lagjes që të gjejnë, t’u japin mësim dhe të pagëzojnë kërkues. Ai e bashkërendon këtë punë me punën e misionarëve kohëplotë dhe të misionarëve të lagjes. Në mbledhjet e keshillit të lagjes, peshkopi mund t’i kërkojë atij të drejtojë diskutimet mbi punën misionare.

Ai drejton mbledhjet e bashkërendimit të punës misionare dhe punën e misionarëve të lagjes.

Ai organizon çdo javë sa më shumë mundësi mësimdhënieje që të jetë e mundur për misionarët kohëplotë.

Ai organizon shërbimet e pagëzimit për të kthyerit në besim, i ndihmuar nga misionarët kohëplotë (shih 20.3.4).

Ai ndihmon për bashkërendimin e konfirmimeve të anëtarëve të rinj në mbledhjet e sakramentit.

Ai merr pjesë me misionarët kohëplotë në mësimdhënien dhe shoqërimin e kërkuësve.

Ai merr pjesë në klasën e Parimeve të Ungjillit dhe mund të japë mësim në klasë kur caktohet nga peshkopata.

Një mbajtës i Priftërisë Melkizedeke mund të thirret si ndihmës i udhëheqësit të misionit të lagjes.

#### 5.1.4 Misionarët e Lagjes

Peshkopata dhe udhëheqësi i misionit i lagjes përcaktojnë se sa misionarë të lagjes nevojiten në lagje. Misionarët e lagjes shërbejnë nën drejtimin e tyre. Mbajtësit e priftërisë, motrat dhe çiftet e martuara mund të shërbejnë si misionarë të lagjes. Ata nuk kanë nevojë të kenë shokë të caktuar, por nuk duhet të shkojnë vetëm kur vizitojnë në shtëpi. Një burrë e një grua nuk bëjnë vizita së bashku si misionarë të lagjes, përveç nëse janë bashkëshort e bashkëshorte.

Misionarët e lagjes thirren për një afat të përcaktuar shërbimi, të tillë si dy vjet. Normalisht ata nuk kanë përgjegjësi të tjera në Kishë, përveç deyrave si mësues të shtëpisë ose mësuese vizitore, më mirë për familje pjesërisht anëtare ose më pak aktive. Ata nuk mbajnë etiketa emri.

Misionarët e lagjes gjejnë dhe përgatisin njerëz që t'u japin mësim misionarët kohëplotë. Ata ndihmojnë gjithashtu për shoqërimin dhe mësimdhënien për kërkuësit.

Misionarët e lagjes vizitojnë shtëpitë e anëtarëve për të inkurajuar anëtarët që të kërkojnë përvoja misionare, për të dalluar njerëz të cilëve mund t'u japin mësim misionarët dhe për të përgatitur njerëz që të marrin mësim.

#### 5.1.5 Mbledhja e Bashkërendimit Misionar

Udhëheqësi i misionit i lagjes drejton një mbledhje bashkërendimi misionar me misionarët e lagjes dhe misionarët kohëplotë. Mbledhja zhvillohet rregullisht. Nëse misionarët kohëplotë shërbejnë në disa lagje, ata marrin pjesë aq shpesh sa ta lejojnë rrethanat.

Në këtë mbledhje, udhëheqësi i misionit i lagjes bashkërendon punën e misionarëve kohëplotë dhe të anëtarëve të lagjes. Udhëheqësi i misionit i lagjes mund të drejtojë gjithashtu diskutime mbi zbatimin e planit misionar të lagjes, programimin e sa më shumë takimeve për mësimdhënie që të

jetë e mundur për misionarët dhe organizimin për të pasur anëtarë të pranishëm sa më shpesh të jetë e mundur kur u jepet mësim kërkuësve.

#### 5.1.6 Anëtarët dhe Misionarët Kohëplotë në Punë së Bashku

Presidenti i misionit mban çelësat për pagëzimin dhe konfirmimin e të kthyerve. Në drejtimin e tij, misionarët kohëplotë kanë përgjegjësinë parësore për t'u dhënë mësim kërkuësve. Misionarët kohëplotë gjithashtu drejtojnë intervistat e pagëzimit e të konfirmimit për çdo kandidat dhe autorizojnë që të kryhen ordinancat.

Peshkopi njihet me të gjithë kërkuësit dhe ndjek përparimin e tyre. Edhe pse ai nuk i interviston kandidatët për pagëzim, ai i takon ata personalisht përpara se të pagëzohen. Ai gjithashtu mbikëqyr përpjekjet e anëtarëve të lagjes për t'i shoqëruar ata. Kërkuësit ka më shumë të ngjarë që të pagëzohen, të konfirmohen dhe të qëndrojnë aktivë kur kanë miqësi të ngushtë me anëtarët e Kishës.

Normalisht, shoqërimet misionare kohëplota nuk ndahen për të punuar me anëtarët e lagjes. Megjithatë, ato mund të ndahen për të punuar me anëtarët kur është e nevojshme për të plotësuar një numër të madh takimesh mësimdhënieje. Në raste të tilla, udhëheqësi i misionit i lagjes siguron që ata që punojnë si shokë për misionarët kohëplotë, t'i kuptojnë e t'i pranojnë rregullat e misionit. Ai i udhëzon ata se asnjëherë nuk duhet ta lënë një misionar kohëplotë pa një shok të autorizuar.

#### 5.1.7 Shërbimet e Pagëzimit dhe Konfirmimit

Shërbimet e pagëzimit duhet të programohen sapo një kërkuës të jetë zotuar që të pagëzohet. Shërbimet normalisht, nuk duhet të shtyhen përtej kësaj date përveç nëse personi nuk është i përgatitur. Pagëzimet e pjesëtarëve të familjeve nuk duhet të shtyhen që babai të mund të marrë priftërinë dhe t'i kryejë vetë pagëzimet.

Një shërbim pagëzimi ofron mundësinë për të gjetur dhe inkurajuar kërkuës të tjerë. Të kthyerit duhet të inkurajohen që të ftojnë pjesëtarët e familjeve të tyre, të afërm të tjerë dhe miq. Udhëheqësit e Kishës dhe misionarët mund të ftojnë gjithashtu kërkuës të tjerë që po marrin mësimet, kërkuës të mundshëm dhe udhëheqës e anëtarë që do të punojnë me anëtarët e rinj. Anëtarë të tjerë të lagjes mund të marrin pjesë gjithashtu.

Të kthyerit në besim konfirmohen në një mbledhje sakramenti në lagjen ku banojnë, parapëlqehet të dielën që vjen pas pagëzimit të tyre.

Udhëzimet për shërbimet e pagëzimit dhe konfirmimet, përfshirë udhëzimet për pagëzimet dhe konfirmimet e 8-vjeçarëve, gjenden në 20.3.

### 5.1.8 Plani Misionar i Lagjes

Nën drejtimin e peshkopit, këshilli i lagjes zhvillon një plan misionar të lagjes. Plani duhet të jetë i shkurtër dhe i thjeshtë. Ai duhet të përfshijë synime dhe aktivitete të veçanta për të ndihmuar anëtarët e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse të lagjes që të marrin pjesë në punën misionare të anëtarit, mbajtjen e të kthyerve dhe aktivizimin. Këshilli i lagjes bashkërendon planin misionar të lagjes me planet e misionarëve kohëplotë të caktuar në lagje. Hapat vijues mund të jenë të dobishëm në këtë proces planifikimi:

1. Merrni parasysh nevojat dhe burimet e lagjes për punën misionare të anëtarit, mbajtjen e të kthyerve dhe aktivizimin, përfshirë disponueshmërinë e misionarëve kohëplotë.
2. Vendosni synime të veçanta për punën misionare të anëtarit, mbajtjen e të kthyerve dhe aktivizimin, që të përmbushen brenda vitit të ardhshëm.
3. Përcaktoni se si t'i përmbushni synimet. Udhëheqësit mund të planifikojnë mënyra për të përmirësuar këndvështrimin e përgjithshëm dhe qëndrimin e anëtarëve të lagjes mbi punën misionare. Ata mund të zhvillojnë ide për aktivitete që të ndihmojnë misionarët kohëplotë të gjejnë, t'u japin mësim dhe të pagëzojnë më shumë kërkues. Ata mund të planifikojnë gjithashtu mënyra për t'u miqësuar e për të forcuar anëtarët e rinj dhe të përmirësojnë aktivizimin e anëtarëve më pak aktivë.

Këshilli i lagjes këqyr rregullisht planin misionar të lagjes dhe e rishikon atë si të jetë e nevojshme.

### 5.1.9 Udhëheqësit e Kunjtit

#### Presidenti i Kunjtit dhe Këshilltarët e Tij

Presidenti i kunjtit dhe këshilltarët e tij i japin përparësi punës misionare. Ata japin mësim rregullisht doktrinën e punës misionare dhe i inkurajojnë anëtarët e kunjtit për të punuar me misionarët kohëplotë që të gjejnë, t'u japin mësim dhe të pagëzojnë kërkues. Ata japin shembullin duke gjetur dhe përgatitur individë dhe familje që t'u japin mësim misionarët.

Në intervistën e tij të rregullt me secilin peshkop, presidenti i kunjtit kërkon një raport mbi përparimin e kërkuesve në lagjen e peshkopit.

Presidenti i kunjtit takohet rregullisht me presidentin e misionit për të bashkërenduar punën e misionarëve kohëplotë në kunj. Çështjet për diskutim përfshijnë numrin dhe vendndodhjen e misionarëve, rolin e anëtarëve në punën misionare, ndihmën e misionarëve në përpjekjet e mbajtjes dhe aktivizimit, ndihmën e misionarëve për trajnimin e anëtarëve vendorë dhe vaktet ushqimore, strehimin dhe transportimin për misionarët.

#### Këshilltari i Lartë i Caktuar për Punën Misionare

Presidenca e kunjtit cakton një këshilltar të lartë të orientuar nga puna misionare për ta ndihmuar atë për mbikëqyrjen e përpjekjeve të kunjtit për të gjetur, për t'u dhënë mësim, për të pagëzuar dhe për të konfirmuar kërkues. Ky këshilltar i lartë mund të drejtojë diskutime mbi këto tema në mbledhjet e komitetit ekzekutiv të priftërisë së kunjtit, mbledhjet e këshillit të kunjtit, mbledhjet e udhëheqjes së priftërisë të kunjtit dhe mbledhjet e tjera të kunjtit.

Këshilltari i lartë i caktuar për punën misionare orienton udhëheqësit e sapothirrur të misionit të lagjes. Ai gjithashtu siguron udhëzim e inkurajim të vazhdueshëm për të gjithë udhëheqësit e misionit të lagjes, edhe si individë edhe si grup. Me miratimin e presidentit të kunjtit, ai mund të trajtojë udhëheqës të lagjes dhe misionarë të lagjes.

---

## 5.2 Mbajtja e të Kthyerve në Besim

Anëtarët e rinj të Kishës kanë nevojë për mbështetjen dhe miqësinë e udhëheqësve të Kishës, mësuesve të shtëpisë, mësuesve vizitore dhe anëtarëve të tjerë. Kjo mbështetje i ndihmon anëtarët e rinj që të "[kthehen] në besim te Zoti" vendosmërisht (Alma 23:6).

### 5.2.1 Nevojat e Anëtarëve të Rinj

Kalimi në anëtarësinë në Kishë është sfidues për shumicën e njerëzve. Shpesh ai përfshin përqafimin e mësimave të reja fetare dhe një mënyrë të re të jetuarit. Të gjithë anëtarët e Kishës, veçanërisht anëtarët e rinj, kanë nevojë për tre gjëra që t'i ndihmojnë ata të mbeten aktivë në Kishë: miqësi, mundësi për t'u zhvilluar e për të shërbyer në Kishë dhe ushqimin nga fjala e mirë e Perëndisë (shih Moroni 6:4). Nën drejtimin e peshkopatës, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse i ndihmojnë anëtarët e rinj në këto fusha.

### 5.2.2 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij

Peshkopi ka përgjegjësinë e plotë për mbajtjen e të kthyerve në besim. Për të ndihmuar anëtarët e rinj që të mbeten aktivë në Kishë, peshkopi

dhe këshilltarët e tij kanë përgjegjësitë vijuese. Peshkopi mund të caktojë njërin prej këshilltarëve të tij që të bashkërendojë këto përpjekje.

Ata mbikëqyrin përpjekjet që të sigurohen që çdo anëtar i ri të marrë shoqërim.

Ata sigurohen që çdo anëtar i ri i rritur të marrë një thirrje ose mundësi të tjera për të shërbyer.

Ata sigurohen që vëllezërit e moshave 12 vjeç e sipër të shugurohen në detyrën përkatëse në Priftërinë Aarone menjëherë pas konfirmimit të tyre, normalisht brenda një jave. Ata gjithashtu kujdesen që këta vëllezër të kenë mundësi ta ushtrojnë priftërinë. Vëllezërit që janë të denjë për t'u pagëzuar e konfirmuar, janë gjithashtu të denjë për të marrë Priftërinë Aarone.

Peshkopi dhe këshilltarët e tij mbikëqyrin punën e udhëheqësit të grupit të priftërinjve të lartë dhe të presidentit të kuorumit të pleqve për të ndihmuar vëllezërit e moshave 18 vjeç e sipër që të përgatiten për të marrë Priftërinë Melkizedeke. Vëllezërit e pagëzuar së fundi të moshave 18 vjeç e sipër shugurohen pleq pasi të kenë shërbyer si priftërinj, të kenë zhvilluar kuptueshmëri të mjaftueshme për ungjillin dhe ta kenë treguar denjësinë e tyre. Nuk kërkohet kohëzgjatje e caktuar si anëtar.

### 5.2.3 Këshilli i Lagjes

Në mbledhjet e këshillit të lagjes, anëtarët e këshillit këqyrin synimet e tyre për mbajtjen e të kthyerve në besim siç përvijohet në planin misionar të lagjes (shih 5.1.8). Ata diskutojnë përparimin e çdo anëtari të ri dhe dallojnë fusha ku atij ose asaj mund t'i nevojitet më shumë mbështetje. Ata mund të përdorin formularin Përparimi i Anëtarit të Ri dhe të Kthyer në Aktivitet si udhëzues për këtë diskutim. Ata këshillohen mbi mënyra se si anëtarët e rinj mund të ndiejnë dashurinë e anëtarëve të tjerë, gëzimin e shërbimit në mbretërinë e Zotit dhe paqen që vjen nëpërmjet të jetuarit të parimeve të ungjillit.

Këshilli i lagjes mund të diskutojë mënyra se si mund të punojë udhëheqësi i misionit të lagjes me udhëheqës të tjerë të priftërisë dhe të organizatave ndihmëse për të forcuar të kthyerit e rinj në besim. Anëtarët e këshillit të lagjes mund të sugjerojnë gjithashtu raste të mundshme për shërbim që mund t'u jepen anëtarëve të rinj, të tilla si puna në tempull dhe për historinë familjare.

### 5.2.4 Udhëheqësit e Priftërisë dhe të Organizatave Ndhimëse

Si të drejtohen nga peshkopata, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse sigurojnë

mundësi që i ndihmojnë anëtarët e rinj të pihen shpirtërisht dhe të mbeten aktivë në Kishë. Për shembull, presidentja e Shoqatës së Ndhimës është përgjegjëse për të ndihmuar femrat e rritura të kthyer në besim. Për shkak se një mashkull i rritur i kthyer në besim është një plak i mundshëm, ose presidenti i kuorumit të pleqve, ose udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë, është përgjegjës për të ndihmuar në përparimin e tij, siç përcaktohet nga peshkopata. Kur më shumë se një anëtar i familjes bashkohet me Kishën, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse bashkërendojnë përpjekjet e tyre në mbledhjet e këshillit të lagjes.

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse i ndihmojnë anëtarët e rinj në mënyrat vijuese:

Ata ndihmojnë anëtarët e rinj që të kuptojnë dhe zbatojnë doktrinën dhe parimet në mësimet misionare.

Ata sigurohen që anëtarët e rinj të mësojnë praktikën bazë të Kishës, të tilla si të japin dëshmi, të paguajnë të dhjetën dhe oferta të tjera, të jetojnë ligjin e agjërimit, të japin një bisedë, të kryejnë ordinancën priftërie, të marrin pjesë në punën e historisë familjare, të kryejnë pagëzime dhe konfirmime për të vdekurit (ku është e mundur) dhe të shërbejnë si mësues shtëpie ose mësuese vizitore.

Ata sigurojnë që anëtarët e rinj të kenë mundësi përdorimi të shkrimeve të shenjta, revistave të Kishës dhe çfarëdo manuali që mund t'u nevojitet për orët mësimore të Kishës ku marrin pjesë.

Nëse anëtarët e rinj kanë të drejtën për seminar ose institut, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse i ndihmojnë ata të regjistrohen.

Kur anëtarët e rinj fitojnë të drejtën për të marrë ordinancat e tempullit, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse i ndihmojnë ata të përgatiten, ose në një seminar përgatitjeje për tempull ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse mund të caktojnë anëtarë me përvojë që të ndihmojnë për shoqërimin e anëtarëve të rinj. Udhëheqësit mund të marrin parasysh të caktojnë anëtarë që lidhen mirë me anëtarët e rinj për shkak të interesave të ngjashme ose për shkak se kanë përballuar sfida të ngjashme.

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse (ose anëtarët që caktojnë ata) shënojnë çdo javë nëse anëtarët e sapopagëzuar që i përkasin kuorumit ose organizatës ndihmëse të tyre, janë të pranishëm në mbledhjen e sakramentit. Ata caktojnë detyra për të vizituar ata që nuk po marrin pjesë dhe i ftojnë ata të marrin pjesë javën vijuese.

### 5.2.5 Mësuesit e Shtëpisë dhe Mësueset Vizitore

Mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore kanë përgjegjësi të rëndësishme për të krijuar miqësi me anëtarët e rinj. Në këshillim me peshkopin, udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhmës i japin përparësi të lartë caktimit të mësuesve të shtëpisë dhe mësueseve vizitore të dedikuara për anëtarët e rinj.

Kur autorizohen nga presidenti i misionit, misionarët kohëplotë mund të ndihmojnë në mësimin e shtëpisë dhe vizitat mësimore për anëtarët e rinj.

### 5.2.6 Misionarët e Lagjes dhe Misionarët Kohëplotë

Ndërsa mbajtja e të kthyerve është kryesisht përgjegjësi e udhëheqësve të priftërisë dhe të organizatave ndihmëse të lagjes, misionarët e lagjes dhe misionarët kohëplotë ndihmojnë në këtë punë. Misionarët e lagjes u japin mësim sërish katër mësimet e para misionare të gjithë anëtarëve të rinj (shih *Predikoni Ungjillin Tim*, kapitulli 3). Ata zhvillojnë gjithashtu mësimin 5. Misionarët e lagjes mund të ndihmohen nga misionarët kohëplotë, si të jetë e nevojshme.

### 5.2.7 Ndikimi i Anëtarëve të Tjerë të Lagjes

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse i inkurajojnë anëtarët e lagjes që të forcojnë anëtarët e rinj duke u treguar dashuri dhe duke krijuar miqësi. Udhëheqësit mund t'i inkurajojnë anëtarët e lagjes që t'i ftojnë të kthyerit rishtas në besim që të marrin pjesë me ta në mbremje familjare, mbledhje të Kishës, orë mësimore dhe aktivitete, duke siguruar transport nëse nevojitet.

### 5.2.8 Klasa e Parimeve të Ungjillit

Anëtarët e rinj të moshave 18 vjeç e lart, marrin pjesë në klasën e Parimeve të Ungjillit gjatë Shkollës të së Dielës, bashkë me kërkuesit. Anëtarët e rinj zakonisht marrin pjesë në klasën e Parimeve të Ungjillit për disa muaj. Kur të jenë gati, ata marrin pjesë në klasën e Doktrinës së Ungjillit.

Udhëheqësi i misionit i lagjes merr pjesë në klasën e Parimeve të Ungjillit. Ai bashkërendon klasën me përpjekjet e tjera në lagje për mbajtjen e të kthyerve. Një anëtar i peshkopatës mund t'i caktojë atij që të japë mësimin. Misionarët e tjerë të lagjes mund të marrin pjesë gjithashtu.

Mësuesit e shtëpisë, mësueset vizitore dhe anëtarët e tjerë mund të marrin pjesë në klasë për të siguruar shoqërim. Herë pas here, mësuesi mund të ftojë anëtarë të tjerë të lagjes që të marrin

pjesë dhe të ndajnë përvoja dhe dëshmi. Për shembull, mësuesi mund të ftojë anëtarë të lagjes që të ndajnë dëshmitë e tyre për bekimet e dhënies së të dhjetës, përvojat e tyre për kapërcimin e sfidave, ose bekimet që kanë marrë kur kanë shërbyer në thirrje në Kishë.

Mësuesit e këtij kursi kanë përgjegjësitë që vijojnë:

Ata përzgjedhin dhe zhvillojnë mësim nga *Parimet e Ungjillit*. Kur japin mësim, ata i përdorin shpesh shkrimet e shenjtja, veçanërisht Librin e Mormonit. Ata i përshtasin mësimet sipas nevojave të anëtarëve të klasës dhe i ftojnë anëtarët e klasës që të ndajnë mendimet dhe përvojat e tyre.

Ata krijojnë një mjedis që fton Shpirtin, duke dhënë shpesh dëshmi.

Ata i inkurajojnë anëtarët e klasës që të lexojnë rregullisht Librin e Mormonit dhe të ndajnë përshypje nga leximi i tyre.

### 5.2.9 Udhëheqësit e Kunjtit

#### Presidenti i Kunjtit dhe Këshilltarët e Tij

Anëtarët e presidencës së kunjtit mbikëqyrin përpjekjet për të forcuar anëtarët e rinj në kunj. Ata udhëzojnë dhe inkurajojnë udhëheqës të tjerë në këto përpjekje. Ata takohen me anëtarët e rinj kur vizitojnë lagjet. Herë pas here ata mund të mbajnë një mbledhje për anëtarët e rinj në lidhje me një konferencë kunjti.

Në intervistën e tij të rregullt me secilin peshkop, presidenti i kunjtit kërkon një raport mbi përparimin e anëtarëve të rinj në lagjen e peshkopit.

Në mbledhjen e tij të zakonshme me presidentin e misionit, presidenti i kunjtit mund të japë një raport mbi përparimin e anëtarëve të rinj në kunj.

#### Këshilltarët e Lartë

Këshilltarët e lartë që punojnë me udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke në lagje, dhe këshilltarët e lartë që punojnë me udhëheqësit e misionit të lagjes, mund të ndihmojnë për t'u dhënë mësim dhe për t'i shoqëruar anëtarët e rinj. Ata mund të marrin pjesë gjithashtu, në përpjekjet për të ndihmuar pleqtë e mundshëm që të përgatiten për të marrë Priftërinë Melkizedeke.

#### Presidencat e Organizatave Ndhmëse të Kunjtit

Presidencat e organizatave ndihmëse të kunjtit mund të punojnë herë pas here me udhëheqësit e organizatave ndihmëse të lagjes për t'u dhënë mësim dhe për t'i shoqëruar anëtarët e rinj.

### 5.3 Aktivizimi

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse të lagjes përpigën fort vazhdimisht që të ndihmojnë anëtarët më pak aktivë për t'u kthyer në aktivitet në Kishë. Shpëtimtari tha: "Të tillëve ju duhet të vazhdoni t'u shërbeni; pasi ju nuk e dini në qoftë se ata do të kthehen dhe pendohen dhe vijnë tek unë me qëllim të plotë të zemrës, dhe unë do t'i shëroj; dhe ju do të jeni mjetet që do t'u sjellin shpëtim atyre" (3 Nefi 18:32).

Anëtarët më pak aktivë zakonisht ende besojnë në ungjill, por ata mund të jenë duke përjetuar sprova të vështira që i bëjnë të mos ndihen rehat lidhur me pjesëmarrjen në kishë. Ata gjithashtu priren të kenë më pak miqësira në Kishë, kështu që ka më pak gjasa të ndiejnë se janë mes miqsh kur shkojnë në mbledhje të lagjes. Ata që kthehen në aktivitet, shpesh e bëjnë këtë kur shohin se diçka po mungon në jetën e tyre. Si rezultat, ata e kuptojnë se kanë nevojë të bëjnë ndryshime në mënyrën si jetojnë. Në kohë të tilla, ata kanë nevojë të ndiejnë dashurinë dhe miqësinë e anëtarëve dashamirës dhe aktivë të Kishës, të cilët i pranojnë ashtu si janë dhe shfaqin interes personal të sinqertë për ta.

#### 5.3.1 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij

Peshkopi dhe këshilltarët e tij kanë përgjegjësinë e plotë për aktivizim. Ata drejojnë përpjekjet e kuorumeve të priftërisë dhe të organizatave ndihmëse për të ndihmuar anëtarët më pak aktivë që të rindezin besimin dhe për të siguruar që anëtarët që kthehen të marrin shoqërim dhe mbështetje. Ata ndihmojnë vëllezërit që kthehen që të përparojnë në priftëri dhe ata ndihmojnë vëllezërit e motrat që të marrin ordinancat e tempullit ose të bëhen të denjë për të hyrë sërish në tempull.

Peshkopi mund të caktojë njërin prej këshilltarëve të tij që të bashkërendojë aktivizimin.

#### 5.3.2 Këshilli i Lagjes

Nën drejtimin e peshkopatës, anëtarët e këshillit të lagjes këqyrin synimet e tyre për aktivizimin siç përvijohet në planin misionar të lagjes (shih 5.1.8). Ata ndajnë rekomandime për t'u shërbyer anëtarëve më pak aktivë në organizatat e tyre. Duke qenë vazhdimisht në dijeni për nevojat dhe rrethanat e anëtarëve më pak aktivë, anëtarët e këshillit të lagjes mund të dallojnë se kur mund të jenë gati familjet dhe individët për t'iu përgjigjur një ftese për të pranuar vizitorë të Kishës, për të marrë pjesë në një aktivitet në Kishë, ose për të marrë pjesë në një seminar përgatitjeje për tempull.

Plot lutje, këshilli i lagjes dallon anëtarët më pak aktivë që ka më shumë gjasa të kthehen në aktivitet. Ata gjithashtu vendosin se cilët udhëheqës dhe anëtarë do të mund të forconin më mirë anëtarët më pak aktivë dhe të krijojnë marrëdhënie personale me ta. Kur më shumë se një anëtar i familjes është më pak aktiv, udhëheqësit bashkërendojnë përpjekjet e tyre në mbledhjet e këshillit të lagjes.

Mbledhjet e këshillit të lagjes përfshijnë rregullisht raporte mbi përparimin e këtyre anëtarëve. Kur disa anëtarë kthehen në aktivitet ose refuzojnë ftesa për t'u kthyer, këshilli i lagjes dallon të tjerë që mund të jenë pranues. Udhëheqësit mund të përdorin formularin Përparimi i Anëtarit të Ri dhe të Kthyer në Aktivitet për të mbajtur shënim për këto përpjekje.

#### 5.3.3 Mësuesit e Shtëpisë dhe Mësueset Vizitore

Duke u këshilluar me peshkopin, udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës caktojnë mësues të shtëpisë dhe mësuese vizitore të përkushtuara për anëtarët më pak aktivë. Këta udhëheqës i përqendrojnë përpjekjet e tyre tek anëtarët më pak aktivë që ka më shumë gjasa t'u përgjigjen ftesave për t'u kthyer në aktivitet.

#### 5.3.4 Misionarët Kohëplotë dhe Misionarët e Lagjes

Udhëheqësi i misionit i lagjes, misionarët kohëplotë dhe misionarët e lagjes mund të ndihmojnë për përpjekjet e aktivizimit kur është me vend, veçanërisht kur mësimdhënia e tyre për anëtarët më pak aktivë do të krijojë mundësi që misionarët t'u japin mësim miqve ose të afërmeve joanëtarë të këtyre anëtarëve.

#### 5.3.5 Klasa e Parimeve të Ungjillit

Anëtarët më pak aktivë të moshave 18 vjeç e lart mund të marrin pjesë në klasën e Parimeve të Ungjillit gjatë Shkollës të së Dielës (shih 5.2.8).

#### 5.3.6 Udhëheqësit e Kunjit

##### Presidenti i Kunjit dhe Këshilltarët e Tij

Në intervistën e tij të zakonshme me secilin peshkop, presidenti i kunjit kërkon një raport mbi përparimin e anëtarëve më pak aktivë në lagjen e peshkopit. Presidenti i kunjit dhe peshkopi diskutojnë planet dhe synimet e përgatitura nga këshilli i lagjes për këta anëtarë.

Kur presidenti i kunjit dhe presidenti i misionit takohen për të diskutuar mbi punën misionare, ata mund të diskutojnë gjithashtu mbi ndihmën

që mund të japin misionarët kohëplotë në punën me anëtarët më pak aktivë.

#### Këshilltarët e Lartë

Këshilltarët e lartë që punojnë me udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke në lagje, mund të ndihmojnë për t'u dhënë mësim dhe për t'i shoqëruar anëtarët më pak aktivë. Ata mund të marrin pjesë gjithashtu, në përpjekjet për të ndihmuar pleqtë e mundshëm që të përgatiten për të marrë Priftërinë Melkizedeke.

#### Presidencat e Organizatave Ndhmëse të Kunj

Presidencat e organizatave ndhmëse të kunjit mund të punojnë herë pas here me udhëheqësit e organizatave ndhmëse të lagjes për t'u dhënë mësim dhe për t'u shoqëruar me anëtarët më pak aktivë.

### 5.4 Puna në Tempull dhe për Historinë Familjare

Në tempuj, anëtarët e Kishës marrin ordinanca dhe bëjnë besëlidhje të shenjta që janë thelbësore për ekzaltim. Anëtarët e Kishës shkojnë gjithashtu në tempuj për të kryer ordinanca në emër të personave të vdekur, të cilët nuk i kanë marrë ordinancat.

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndhmëse u japin mësim anëtarëve të lagjes mbi përgjegjësitë bazë për punën në tempull dhe të historisë familjare, siç përvijohet në paragrafët vijues:

Ata i inkurajojnë anëtarët të marrin vetë ordinancat e tyre të tempullit dhe të ndihmojnë pjesëtarët e afërt të familjes që të marrin të tyret. Udhëheqësit u mësojnë anëtarëve se qëllimi i indaumentit është të përgatiten për ekzaltim, jo thjesht të përgatiten për martesë ose një mision.

Udhëheqësit e inkurajojnë çdo anëtar që ka marrë indaumentin, që të mbajë një rekomandim aktual tempulli dhe që të shkojë në tempull sa më shpesh që ta lejojnë rrethanat dhe nevojat familjare. Udhëheqësit inkurajojnë gjithashtu të rriturit që nuk kanë marrë indaumentin, dhe rininë e moshave 12 vjeç e sipër, përfshirë anëtarët e rinj, që të kenë rekomandime tempulli për përdorim të kufizuar dhe të shkojnë shpesh në tempull për t'u pagëzuar e konfirmuar për të vdekurit. Udhëheqësit nuk vendosin synime statistikore ose sisteme raportimi për pjesëmarrjen në tempull. Secili anëtar përcakton nivelin e tij apo të saj të pjesëmarrjes në punën në tempull.

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndhmëse u mësojnë anëtarëve të marrin pjesë në punën për historinë familjare duke identifikuar

pjesëtarët e familjeve të tyre paraardhëse, duke kërkuar ordinanca tempulli për ta nëse nevojitet dhe duke i siguruar vetë këto ordinanca në tempull, nëse është e mundur.

Udhëheqësit i ndihmojnë anëtarët të kuptojnë se ata nuk duhet të kërkojnë që të kryhen ordinanca tempulli për cilindo person jo të afërm, pa miratimin e familjarit më të afërt të gjallë të atij personi. Udhëheqësit i ndihmojnë gjithashtu anëtarët të kuptojnë se ata nuk duhet të bëjnë kërkesa të tilla për njerëz të famshëm që nuk kanë lidhje familjare me ta, ose për njerëz informacioni për të cilët është mbledhur nga projekte indeksimi të pamiratuara.

#### 5.4.1 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij

Peshkopi dhe këshilltarët e tij mbikëqyrin punën në tempull dhe për historinë familjare në lagje. Ata sigurohen që doktrinën dhe bekimet e punës në tempull dhe për historinë familjare të jepen mësim rregullisht në mbledhjet e lagjes.

Kur peshkopi takohet me anëtarët, ai i ndihmon ata të përgatiten për të marrë ordinancat e tempullit dhe që të kualifikohen për të vazhduar që të shkojnë në tempull aq shpesh sa ta lejojnë rrethanat.

Peshkopi dhe këshilltarët e tij i inkurajojnë anëtarët që të identifikojnë pjesëtarët e familjeve të tyre paraardhëse dhe për të siguruar ordinancat e tempullit për ta.

Përgjegjësi të tjera të peshkopatës në lidhje me punën në tempull, përvijohen në *Handbook 1 [Manuali 1]*, kapitulli 3.

#### 5.4.2 Këshilli i Lagjes

Të paktën një herë në tre muaj në një mbledhje të këshillit të lagjes, udhëheqësit marrin parasysh çështje në lidhje me punën në tempull dhe për historinë familjare, si vijon:

Ata diskutojnë mënyra për t'i ndihmuar individët dhe familjet që të marrin ordinancat e tempullit dhe që të shkojnë në tempull aq shpesh sa ta lejojnë rrethanat.

Ata marrin parasysh me lutje anëtarët e lagjes që mund të ftohen për të marrë pjesë në seminare për përgatitje për tempull ose që të punojnë me këshilluesit për historinë familjare.

Ata diskutojnë mënyra se si t'i ndihmojnë anëtarët që të marrin pjesë në punën për historinë familjare.

Ata mund të diskutojnë mënyra se si ta përdorin punën për historinë familjare për të gjetur njerëz që t'u japin mësim misionarët kohëplotë dhe për të ndihmuar anëtarët e rinj dhe më pak aktivë.

### 5.4.3 Udhëheqësi i Grupit të Priftërinjve të Lartë

Udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë bashkërendon përpjekjet e këshillit të lagjes për të inkurajuar punën në tempull dhe për historinë familjare në lagje.

Udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë gjithashtu bashkërendon punën e këshilluesve për historinë familjare. Nëse kuni ka një qendër për historinë familjare, ai cakton këshillues që të shërbejnë atje si anëtarë personeli, si të kërkohet nga drejtori i qendrës për historinë familjare. Nëse kuni merr pjesë në indeksim të FamilySearch, ai rekomandon individë që të shërbejnë si punonjës për indeksim të FamilySearch.

Nëse lagja nuk ka një udhëheqës të grupit të priftërinjve të lartë, këtë rol e luan presidenti i kuorumit të pleqve ose një mbajtës tjetër i caktuar i Priftërisë Melkizedeke.

### 5.4.4 Këshilluesit për Historinë Familjare

Nën drejtimin e udhëheqësit të grupit të priftërinjve të lartë, këshilluesit për historinë familjare kanë përgjegjësitë vijuese. Ata përdorin si burim *Member's Guide to Temple and Family History Work [Udhëzuesin e Anëtarit për Punën në Tempull dhe për Historinë Familjare]*.

Ata ndihmojnë anëtarët që të identifikojnë pjesëtarë të familjeve paraardhëse. Ata ndihmojnë anëtarët të përgatisin informacion që të mund të kryhen ordianca në tempull për pjesëtarët e familjeve të tyre paraardhëse. Ata ndihmojnë anëtarët që nuk kanë qasje tek kompjuterat ose që nuk ndihen të sigurt për përdorimin e kompjuterave. Aty ku është e mundur, ata e sigurojnë këtë ndihmë në shtëpitë e anëtarëve.

Ata shërbejnë rregullisht si anëtarë personeli në një qendër për historinë familjare, si të caktohen. Ata mund të caktohen gjithashtu që të japin mësim klasat për historinë familjare në lagje.

Për informacion shtesë mbi përgjegjësitë e këshilluesve për historinë familjare, shih *Family History Consultant's Guide to Temple and Family History Work [Udhëzuesin e Këshilluesit për Historinë Familjare për Punën në Tempull dhe për Historinë Familjare]* që gjendet tek LDS.org.

### 5.4.5 Klasat dhe Burimet për Punën në Tempull dhe për Historinë Familjare

#### Seminaret e Përgatitjes për Tempull

Seminaret e përgatitjes për tempull i ndihmojnë anëtarët që të përgatiten për të marrë ordiancat dhe bekimet e tempullit. Këto seminare planifikohen nën drejtimin e peshkopit. Ato jepen

mësim tek shtëpia e mbledhjeve ose në një shtëpi, aq shpesh sa të nevojitet.

Seminaret e përgatitjes për tempull janë veçanërisht të dobishme për anëtarët e rinj, anëtarët më pak aktivë që po kthehen në aktivitet në Kishë dhe anëtarët që kanë marrë indaumentin, të cilët nuk i kanë përtëritur rekomandimet e tyre për një periudhë kohe të zgjatur. Seminaret mund të jenë të dobishme gjithashtu për anëtarët aktivë që po përgatiten për të marrë indaumentin.

Nën drejtimin e peshkopit, me lutje, anëtarët e këshillit të lagjes përzgjedhin anëtarët për t'i ftuar në secilin seminar.

Peshkopata thërret një ose më shumë mësues, të cilët mund të jenë burrë e grua. Mësimet dhe udhëzimet për organizimin e kursit gjenden në *I Dhuruar nga Lart: Manuali i Mësuesit për Seminarin e Përgatitjes për në Tempull*. Pjesëmarrësit në seminar duhet të marrin kopjet e tyre të broshurës *Në Përgatitje për të Hyrë në Tempullin e Shenjtë*.

#### Kursi i Historisë Familjare

Një kurs i historisë familjare mund të zhvillohet gjatë Shkollës të së Dielës ose në një kohë tjetër që është më e përshtatshme për anëtarët. Ky kurs organizohet nën drejtimin e peshkopatës më tepër se të presidentit të Shkollës të së Dielës. Mësuesi përdor *Instructor's Guide to Temple and Family History Work [Udhëzuesin e Instrukturit për Punën në Tempull dhe për Historinë Familjare]* për të zhvilluar mësimet. Mësuesi zakonisht është një këshillues për historinë familjare i caktuar nga peshkopata. Mësimet drejtohen përgjithësisht si seminare praktike në të cilat anëtarët faktikisht plotësojnë punën për historinë familjare.

#### Qasja në Burime për Historinë Familjare në Internet

Burimet e Kishës për historinë familjare në internet i ndihmojnë anëtarët që të identifikojnë pjesëtarët e familjeve të tyre paraardhëse, të organizojnë informacionin për paraardhësit dhe të paraqesin kërkesa që ordianca tempulli të kryhen për këta pjesëtarë të familjes. Shumica e këtyre burimeve mund të gjenden nëpërmjet faqes së internetit të Kishës për historinë familjare, FamilySearch.org.

Atje ku shtëpia e mbledhjeve e lagjes apo e kunjit ka kompjutera me lidhje interneti, ose atje ku programet për historinë familjare janë të instaluar në kompjutera të kunjit ose të lagjes, presidenca e kunjit dhe peshkopata sigurohen që këta kompjutera të jenë të disponueshëm që anëtarët t'i përdorin në kohë të arsyeshme. Këshilluesit për historinë familjare mund të ndihmojnë për të

planifikuar përdorimin e kompjuterave dhe për t'u mësuar anëtarëve se si t'i përdorin ata.

Anëtarët që përdorin kompjuterat administrativë të Kishës për punë të historisë familjare, nuk duhet të kenë qasje në informacionin financiar ose të anëtarësisë.

#### 5.4.6 Udhëheqësit e Kunjtit

##### Presidenti i Kunjtit dhe Këshilltarët e Tij

Presidenti i kunjtit dhe këshilltarët e tij mbikëqyrin punën në tempull dhe për historinë familjare në kunj. Ata sigurohen që doktrinat dhe bekimet e kësaj pune të jepen mësim rregullisht në mbledhjet e kunjtit.

Kur presidenti i kunjtit takohet me anëtarët, ai i ndihmon ata të përgatiten për të marrë ordinancat e tempullit dhe që të kualifikohen për të vazhduar që të shkojnë në tempull aq shpesh sa ta lejojnë rrethanat.

Presidenti i kunjtit dhe këshilltarët e tij i inkurajojnë anëtarët që të identifikojnë pjesëtarët e familjeve të tyre paraardhëse dhe për të siguruar ordinancat e tempullit për ta.

Përgjegjësi të tjera të presidencës së kunjtit në lidhje me punën në tempull, përvijohen në *Handbook 1 [Manuali 1]*, kapitulli 3.

##### Këshilltari/ët i/e Lartë i/të Caktuar për Punën në Tempull dhe për Historinë Familjare

Presidenca e kunjtit mund të caktojë një ose më shumë këshilltarë të lartë që të udhëzojnë udhëheqësit e grupit të priftërinjve të lartë dhe të kuorumit të pleqve mbi përgjegjësitë e tyre për tempullin dhe historinë familjare. Si të nevojitet, këta këshilltarë të lartë gjithashtu bashkërendojnë përpjekjet e kunjtit për indeksimin në FamilySearch dhe në qendrat e historisë familjare.

#### 5.4.7 Burimet për Tempullin dhe për Historinë Familjare në Kunj

##### Programi i Indeksimit i FamilySearch në Kunj

Në indeksimin e FamilySearch, pjesëmarrësit përdorin kompjuterat e tyre për të përdorur figura të dokumenteve të tilla si regjistrime zyrtare të popullsisë, regjistra të kishës dhe dokumente demografike. Prej këtyre figurave, ata krijojnë indekse të automatizuara që mund të gjenden pastaj nëpërmjet FamilySearch.org.

Individët, duke përfshirë dhe ata që nuk janë anëtarë të Kishës, mund të bëjnë vetë indeksim për FamilySearch. Megjithatë, presidenca e kunjtit mund të përcaktojë se do të ishte me dobi për

anëtarët e kunjtit që të punojnë së bashku në një program indeksimi. Një përpjekje e tillë mund të sigurojë mundësi shërbimi për anëtarët që janë më pak aktivë ose të pamundur të dalin nga shtëpia. Rinia mund të marrë pjesë gjithashtu.

Për informacion mbi krijimin e një programi indeksimi për FamilySearch, shih *Administrative Guide for Family History [Udhëzues Administrimi për Historinë Familjare]*, që mund të gjendet në LDS.org.

##### Qendra për Historinë Familjare

Disa kunje kanë qendra për historinë familjare, që ekzistojnë kryesisht për të ndihmuar anëtarët e Kishës që të identifikojnë pjesëtarët e familjeve të tyre paraardhëse dhe që të sigurojnë ordinanca tempulli për ta. Përkrahës nga komuniteti janë gjithashtu të mirëpritur që t'i përdorin burimet në qendrat për historinë familjare.

Këto qendra sigurojnë qasje për regjistrime të mikrofilmuara të Kishës për historinë familjare, për kompjutera të historisë familjare dhe burime në internet të tilla si FamilySearch, si edhe trajnim mbi mënyrën se si të bëhet punë për historinë familjare.

Për informacion të mëtejshëm mbi qendrat për historinë familjare, shih *Administrative Guide for Family History [Udhëzues Administrimi për Historinë Familjare]*, që mund të gjendet në LDS.org.

---

## 5.5 Mësimdhënia e Ungjillit

Mësimdhënia efektive e ungjillit i ndihmon njerëzit të rriten në dëshmitë e tyre dhe në besimin e tyre tek Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. Ajo i forcon anëtarët në përpjekjet e tyre për të jetuar sipas parimeve të ungjillit. Kur fjala e Perëndisë jepet mësim me fuqi shpirtërore, ajo ka një "ndikim më të fuqishëm mbi mendjet e njerëzve sesa . . . çdo gjë tjetër" (Alma 31:5). Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse inkurajojnë mësimdhënien efektive në organizatat e tyre. Ata kujtojnë se anëtarët e Kishës marrin pjesë në mbledhjet duke kërkuar fuqi, paqe dhe frymëzim që sigurohet nga fjala e Perëndisë.

### 5.5.1 Peshkopi dhe Këshilltarët e Tij

Peshkopi dhe këshilltarët e tij e japin mësim ungjillin me anë të fuqisë së Shpirtit dhe me anë të shembullit personal. Ata drejtojnë përpjekjet e këshillit të lagjes për të siguruar që mësimdhënia në lagje të jetë lartësuese dhe e saktë nga ana doktrimore.

### 5.5.2 Këshilli i Lagjes

Nën drejtimin e peshkopatës, anëtarët e këshillit të lagjes këshillohen rregullisht së bashku se si

të përmirësojnë të mësuarit dhe mësimdhënien e ungjillit në lagje. Peshkopi mund ta ftojë presidentin e Shkollës të së Dielës që t'i udhëheqë këto diskutime dhe të japë udhëzim.

### 5.5.3 Udhëheqësit e Priftërisë dhe të Organizatave Ndihmëse

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse përpiqen fort që të japin mësim ungjillin me efektivitet. Ata janë gjithashtu përgjegjës për përpjekjet për të përmirësuar të mësuarit dhe mësimdhënien në organizatat e tyre. Në këto përpjekje, ata mund të këshillohen me presidentin e Shkollës të së Dielës të lagjes.

#### Rekomandimi i Anëtarëve për të Shërbyer si Mësues

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse i paraqesin rekomandime peshkopatës për anëtarë të lagjes që të thirren të shërbejnë si mësues në organizatat e tyre. Udhëheqësit duhet të rekomandojnë mësues që do të përpiqen fort që të përgatisin mësime të cilat do t'i frymëzojnë anëtarët e klasës për të jetuar sipas parimeve të ungjillit. Kur bëjnë këtë, ata ndjekin parimet që gjenden në 19.1.1 dhe 19.1.2.

#### Orientimi i Mësuesve të Sapothirur

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse takohen individualisht me mësuesit e sapothirur në organizatat e tyre, parapëlqehet përpara mësimit të parë të çdo mësuesi. Në këto takime, udhëheqësit i orientojnë mësuesit si vijon:

Ata i ndihmojnë mësuesit që të fillojnë të njihen me anëtarët e klasës, nëse është e nevojshme. Ata u japin mësuesve një listë të anëtarëve të klasës dhe inkurajojnë mësuesit që të mësojnë emrat e anëtarëve të klasës. Ata gjithashtu i inkurajojnë mësuesit që të ndërtojnë marrëdhënie dashamirëse me anëtarët e klasës.

Ata i ndihmojnë mësuesit që të kuptojnë se si ta përdorin *Teaching, No Greater Call* [Mësimdhënia, S'Ka Thirrje më të Madhe]. Ata i japin çdo mësuesi një kopje të librit dhe tregojnë një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së tij.

Sipas nevojës, ata i ndihmojnë mësuesit që të kuptojnë se si të përgatisin një mësim. Ata u japin mësuesve materialet e miratuara të programit mësimor për klasat e tyre dhe shpjegojnë se si t'i përdorin ato. Ata këqyrin gjithashtu artikullin me titull "Preparing Lessons" ["Përgatitja e Mësimeve"] në faqet 98–99 në *Teaching, No Greater Call* [Mësimdhënia, S'Ka Thirrje më të Madhe]. (Për një listë të materialeve të miratuara të programit

mësimor dhe udhëzimit se si t'i porosisni ato, shihni materialin më të fundit *Udhëzime mbi Programin Mësimor*.)

#### Sigurimi i Mbështetjes së Vazhdueshme për Mësuesit

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse zhvillojnë një marrëdhënie përkrahëse dhe dashamirëse me mësuesit. Pas mbledhjes së tyre fillestare të orientimit, udhëheqësit takohen rregullisht me mësuesit e veçantë që të mësojnë mbi nevojat e mësuesve, të diskutojnë nevojat e atyre të cilëve u jepet mësim dhe të këqyrin parimet e përvijuara në këtë seksion. Ata i inkurajojnë mësuesit që të vendosin synime sipas artikullit me titull "Making a Plan to Improve Your Teaching" ["Përgatitja e një Plani për të Përmirësuar Mësimdhënien Tuaj"] në faqet 24–27 në *Teaching, No Greater Call* [Mësimdhënia, S'Ka Thirrje më të Madhe].

#### Sigurimi që Mësimdhënia të Jetë Lartësuese dhe e Saktë nga Ana Doktrimore

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse vërejnë me kujdes të mësuarit dhe mësimdhënien gjatë klasave të së dielës dhe mësimeve të tjera. Udhëheqësit që nuk marrin pjesë rregullisht në çdo orë mësimore, të tillë si anëtarët e presidencave të Shkollës të së Dielës dhe të Fillores, e organizojnë me mësuesit që të marrin pjesë në orët mësimore herë pas here. Bazuar në vëzhgimet e tyre, udhëheqësit këshillohen me mësuesit mbi mënyrën se si të përmirësojnë të mësuarit në orët mësimore.

Udhëheqësit sigurohen që mësuesit të përdorin shkrimet e shenjta, mësime të profetëve të ditëve të mëvonshme dhe materialet e miratuara të programit mësimor siç përvijohet në materialin më të fundit *Udhëzime mbi Programin Mësimor*. Ata i ndihmojnë mësuesit që të kuptojnë se si ta plotësojnë programin mësimor me revista të Kishës, veçanërisht botimet e konferencave të përgjithshme të *Ensign* dhe *Liahonave*.

### 5.5.4 Mësuesit dhe Udhëheqësit

Ndërsa mësuesit dhe udhëheqësit japin mësim ungjillin, ata udhëhiqen nga parimet në vijim.

#### Duajini Ata, të Cilëve u Jepni Mësim

Mësuesit dhe udhëheqësit shfaqin dashuri dhe interesim të sinqertë për ata të cilëve u japin mësim. Ata mësojnë emrat e anëtarëve të klasës. Ata këqyrin informacionin mbi pjesëmarrjen që të mund të jenë në dijeni për anëtarët e klasës që nuk po marrin pjesë rregullisht. Ata mund t'i

kontaktojnë këta anëtarë jashtë klase për t'i inkurajuar ata për pjesëmarrjen e tyre.

#### Jepni Mësim me Anë të Shpirtit

Mësuesit dhe udhëheqësit kërkojnë udhëheqjen e Frymës së Shenjtë kur përgatisin dhe zhvillojnë mësimet. Ata e kërkojnë këtë udhëheqje duke u lutur dhe duke njohur përulësisht varësinë e tyre nga Zoti. Gjatë mësimave, ata ftojnë Shpirtin duke dhënë dëshmi për doktrinat që japin mësim.

#### Jepni Mësim Doktrinën

Udhëheqësit dhe mësuesit përdorin shkrimet e shenjta, mësimet e profetëve të ditëve të mëvonshme dhe materialet e miratuara të programit mësimor për të dhënë mësim e për të dëshmuar mbi doktrinat e ungjillit. Materialet e miratuara të programit mësimor për çdo klasë ose kuorum renditen në materialin më të fundit *Udhëzime mbi Programin Mësimor*. Si të nevojitet, mësuesit dhe udhëheqësit i plotësojnë materialet e programit mësimor me revista të Kishës, veçanërisht botimet e konferencave të përgjithshme të *Ensign* dhe *Liahonave*.

#### Ftoni të Mësuarit me Zell

Mësuesit dhe udhëheqësit i inkurajojnë anëtarët e klasës që të jenë përgjegjës për vetë të mësuarin e tyre të ungjillit si individë, në familjet e tyre dhe gjatë udhëzimit në klasë. Ata i inkurajojnë anëtarët e klasës që t'i sjellin në klasë kopjet e veta të shkrimeve të shenjta, aty ku është e mundur. Mësuesit dhe udhëheqësit sigurojnë mundësi që anëtarët e klasës të marrin pjesë aktivisht në diskutime dhe i ftojnë anëtarët e klasës që ta jetojnë ungjillin dhe të marrin bekimet e premtuara.

#### 5.5.5 Presidenti i Shkollës të së Dielës i Lagjes dhe Këshilltarët e Tij

Anëtarët e presidencës së Shkollës të së Dielës të lagjes shërbejnë si burime për të ndihmuar udhëheqës të tjerë me përpjekje për të forcuar të mësuarit dhe mësimdhënien e ungjillit. Ata mund të ftohen që të ndihmojnë udhëheqësit për orientimin, udhëzimin dhe sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme për mësuesit.

#### 5.5.6 Burime të Shtypura dhe në Internet për të Mësuarit dhe Mësimdhënie

Për të ndihmuar anëtarët që të përmirësohen në të mësuarit dhe mësimdhënien e ungjillit, Kisha siguron dy botime: *Teaching, No Greater Call [Mësimdhënia, S'Ka Thirrje më të Madhe]* dhe *Libri Udhëzues i Mësimdhënies*. Këto burime mund të gjenden të shtypura dhe në LDS.org. Burime të tjera mund të gjenden gjithashtu në LDS.org.

#### 5.5.7 Kursi mbi Mësimdhënien e Ungjillit

Peshkopata dhe këshilli i lagjes mund të vendosin herë pas here që të zhvillojnë në lagje kursin Mësimdhënia e Ungjillit. Ky kurs mund t'u sjellë dobi mësuesve aktualë dhe të ndihmojë që të përgatiten mësues të ardhshëm. Ky kurs zhvillohet zakonisht gjatë Shkollës të së Dielës. Mësimet për kursin gjenden në faqet 186–239 në *Teaching, No Greater Call [Mësimdhënia, S'Ka Thirrje më të Madhe]*. Peshkopata cakton presidencën e Shkollës të së Dielës që ta zhvillojë kursin, ose thërret një anëtar tjetër që ta bëjë këtë.

#### 5.5.8 Presidenti i Kunjtit dhe Këshilltarët e Tij

Presidenti i kunjtit dhe këshilltarët e tij japin mësim ungjillin me anë të fuqisë së Shpirtit dhe me anë të shembullit personal. Ata drejtojnë përpjekjet për të siguruar që mësimdhënia në kunj të jetë lartësuese dhe e saktë nga ana doktrimore.

## 6. Parimet dhe Udhëheqja e Mirëqenies

<b>6.1 Qëllimet e Mirëqenies në Kishë</b> . . . . .	<b>36</b>	6.2.4 Grupi i Priftërinjve të Lartë, Kuorumi i Pleqve dhe Shoqata e Ndhmës . . . . .	38
6.1.1 Mbështetja tek Vetja . . . . .	36	6.2.5 Specialistët e Mirëqenies për Lagjen . . . . .	39
6.1.2 Përpyqjet e Anëtarëve që të Kujdesen për të Varfrit e Nevojtarët dhe që të Japin Shërbim . . . . .	37	<b>6.3 Udhëheqja e Mirëqenies në Kunj</b> . . . . .	<b>39</b>
6.1.3 Magazina e Zotit . . . . .	37	6.3.1 Presidenti i Kunjtit . . . . .	39
<b>6.2 Udhëheqja e Mirëqenies në Lagje</b> . . . . .	<b>37</b>	6.3.2 Këshilli i Kunjtit. . . . .	39
6.2.1 Peshkopi . . . . .	37	6.3.3 Specialistët e Mirëqenies të Kunjtit . . . . .	40
6.2.2 Këshilli i Lagjes . . . . .	38	<b>6.4 Konfidencialiteti</b> . . . . .	<b>40</b>
6.2.3 Komiteti Ekzekutiv i Priftërisë i Lagjes . . . . .	38		

## 6. Parimet dhe Udhëheqja e Mirëqenies

### 6.1 Qëllimet e Mirëqenies në Kishë

Qëllimet e mirëqenies në Kishë janë që të ndihmohen anëtarët për t'u bërë të mbështetur tek vetja, për t'u kujdesur për të varfrit e nevojtarët dhe që të jepet shërbim.

Në vitin 1936, Presidenca e Parë paraqiti një plan mirëqenieje për Kishën. Ata thanë: "Qëllimi ynë parësor është të ngremë . . . një sistem nën të cilin mallkimit të përtacisë do t'i jepej fund, të këqiat e ndihmës për papunësinë do të zhdukeshin dhe pavarësia, zelli, ekonomizimi dhe respekti për veten do të vendoseshin edhe një herë mes njerëzve tanë. Qëllimi i Kishës është të ndihmojë njerëzit që të ndihmojnë vetveten. Puna duhet të rikurorëzohet si parimi sundues i jetës së anëtarësisë së Kishës sonë" (në Conference Report, tetor 1936, f. 3).

#### 6.1.1 Mbështetja tek Vetja

Mbështetja tek vetja është aftësia, zotimi dhe përpjekja për të siguruar nevojat shpirtërore dhe fizike të jetës për vete dhe familjen. Kur anëtarët bëhen të mbështetur tek vetja, ata janë gjithashtu më të aftë që të shërbejnë e të kujdesen për të tjerët.

Anëtarët e Kishës janë përgjegjës për mirëqenien e tyre shpirtërore dhe fizike. Të bekuar me dhuratën e lirisë së zgjedhjes, ata kanë privilegjin dhe detyrën që të vendosin drejtimin e vet, të zgjidhin problemet e veta dhe të përqipen fort që të bëhen të mbështetur tek vetja. Anëtarët e bëjnë këtë nën frymëzimin e Zotit dhe me punën e vetë duarve të tyre.

Kur anëtarët e Kishës po bëjnë gjithçka mundën që të sigurojnë për vete, por nuk mund të plotësojnë nevojat e tyre bazë, në përgjithësi ata duhet t'u drejtohen familjeve të tyre për ndihmë. Kur kjo nuk është e mjaftueshme ose e mundshme, Kisha është gati për të ndihmuar.

Disa nga fushat në të cilat anëtarët duhet të bëhen të mbështetur tek vetja përvijohen në paragrafët vijues.

#### Shëndeti

Zoti i ka urdhëruar anëtarët që të kujdesen për mendjen dhe trupin e tyre. Ata duhet t'i binden Fjalës së Urtësisë, të hanë ushqim të shëndetshëm, të ushtrohen rregullisht, të kontrollojnë peshën e tyre dhe të flenë mjaftueshëm. Ata duhet të

shmangin lëndë ose praktika që dëmtojnë trupin ose mendjen e tyre dhe që mund të çojnë në varësi. Ata duhet të praktikojnë pastërti e higjienë të mirë dhe të marrin kujdes të mjaftueshëm mjekësor e dentar. Ata gjithashtu duhet të përqipen fort që të kultivojnë marrëdhënie të mira me pjesëtarët e familjes dhe të tjerët.

#### Arsimi

Arsimi siguron kuptueshmëri dhe aftësi që mund t'i ndihmojnë njerëzit që të zhvillojnë mbështetjen tek vetja. Anëtarët e Kishës duhet të studiojnë shkrimet e shenjta dhe libra të tjerë të mirë. Ata duhet të përmirësohen në aftësitë e tyre për të lexuar, për të shkruar dhe për të bërë llogaritje matematikore bazë. Ata duhet të marrin sa më shumë arsim që të munden, përfshirë shkollim të përgjithshëm ose teknik atje ku është e mundur. Kjo do t'i ndihmojë ata të zhvillojnë talentet e tyre, të gjejnë punësim të përshtatshëm dhe të japin kontribut të vlefshëm për familjet e tyre, Kishën dhe komunitetin.

#### Punësimi

Puna është themeli mbi të cilin qëndrojnë mbështetja tek vetja dhe mirëqenia fizike. Anëtarët duhet të përgatiten për atë dhe të përzgjedhin me kujdes një punë ose vetëpunësim të përshtatshëm që do të sigurojë për nevojat e veta dhe të familjeve të tyre. Ata duhet të bëhen të aftë në punën e tyre, të jenë të zellshëm e të besuar dhe të japin punë të ndershme për pagesën e përfitimet që marrin.

#### Ruajtja në Shtëpi

Për të ndihmuar në përkujdesjen për vete dhe familjet e tyre, anëtarët duhet të krijojnë një furnizim për tre muaj me ushqime që janë pjesë e të ushqyerit të tyre normal. Atje ku e lejojnë ligjet dhe rrethanat vendore, ata duhet të krijojnë gradua-lisht një furnizim për afat më të gjatë me ushqime bazë që mbështesin jetën. Ata gjithashtu duhet të rezervojnë ujë të pijshëm në rast se furnizimi me ujë ndotet ose ndërpritet. (Shih *All Is Safely Gathered In: Family Home Storage*, f. 3.)

#### Burimet Monetare

Që të bëhen financiarisht të mbështetur tek vetja, anëtarët duhet të paguajnë të dhjetat dhe ofertat, të shmangin borxhin e panevojshëm, të përdorin një buxhet dhe të jetojnë sipas një plani.

Ata duhet të krijojnë gradualisht një rezervë financiare duke kursyer rregullisht një pjesë të të ardhurave të tyre. (Shih *All Is Safely Gathered In: Family Home Storage*, f. 3.)

### Forca Shpirtërore

Forca shpirtërore është thelbësore për mirëqenien fizike dhe të përrjetshme të një njeriu. Anëtarët e Kishës rriten në forcë shpirtërore kur zhvillojnë dëshmitë e tyre, ushtrojnë besim tek Ati Qielor dhe Jezu Krishti, u binden urdhërimeve të Perëndisë, luten çdo ditë, studiojnë shkrimet e shenjta dhe mësimet e profetëve të ditëve të mëvonshme, marrin pjesë në mbledhjet e Kishës dhe shërbejnë në thirrjet e detyrat e Kishës.

### 6.1.2 Përpjekjet e Anëtarëve që të Kujdesen për të Varfrit e Nevojtaret dhe që të Japin Shërbim

Nëpërmjet Kishës së Tij, Zoti ka siguruar një mënyrë për t'u kujdesur për të varfrit dhe nevojtaret. Ai u ka kërkuar anëtarëve të Kishës që të japin me bujari në varësi nga ajo çfarë ata kanë marrë prej Tij. Ai u ka kërkuar gjithashtu njerëzve të Tij: "Të vizitoni të varfërit e nevojtaret dhe të administroni në ndihmë të tyre" (DeB 44:6). Anëtarët e Kishës inkurajohen që t'u japin shërbim të dhembshur personal atyre në nevojë. Ata duhet të "përfshihen me zell në një kauzë të mirë", duke shërbyer pa iu kërkuar ose caktuar (shih DeB 58:26–27).

Zoti e ka krijuar ligjin e agjërimit dhe të ofertave të agjërimit për të bekuar njerëzit e Tij dhe për të siguruar një mënyrë për ta që t'u shërbejnë atyre në nevojë (shih Isaia 58:6–12; Malakia 3:8–12). Kur anëtarët agjërojnë, atyre u kërkohet t'i japin Kishës një ofertë agjërimit të barabartë të paktën me vlerën e ushqimit që do të kishin ngrënë. Nëse është e mundur, ata duhet të jenë bujarë dhe të japin më shumë. Bekimet e shoqëruara me ligjin e agjërimit përfshijnë afërsinë me Zotin, forcë të shtuar shpirtërore, mirëqenie fizike, dhembshuri më të madhe dhe një dëshirë më të fortë për të shërbyer.

Disa mundësi për t'u kujdesur për ata në nevojë, vijnë nëpërmjet thirrjeve të Kishës. Mundësi të tjera janë të pranishme në shtëpitë e anëtarëve, në mëhalla dhe komunitete. Anëtarët mund të ndihmojnë gjithashtu të varfrit dhe nevojtaret e të gjitha besimeve në mbarë botën, duke kontribuar për përpjekjet humanitare të Kishës.

Sigurimi në mënyrën e Zotit i përul të pasurit, ekzalton të varfrit dhe i shenjtëron të dy palët (shih DeB 104:15–18). Presidenti J. Ruben Klark i Riu dha mësim:

"Objektivi real afatgjatë i Planit të Mirëqenies është formimi i karakterit tek anëtarët e Kishës, tek dhënësit dhe marrësit, shpëtimi i gjithçkaje më të mirë që është thellë brenda tyre dhe lulëzimi e dhënia fryt e pasurisë së fshehur të shpirtit, që, në fund të fundit, është misioni, qëllimi dhe arsyeja e ekzistencës së kësaj Kishë" (në një takim të veçantë të presidentëve të kunjeve, 2 tetor 1936).

### 6.1.3 Magazina e Zotit

Në disa vendndodhje, Kisha ka ngritur ndërtesa të quajtura magazinat e peshkopëve. Kur anëtarët marrin leje nga peshkopi i tyre, ata mund të shkojnë tek magazina e peshkopëve për të marrë ushqim e veshje. Por magazina e Zotit nuk kufizohet tek një ndërtesë e përdorur për t'u shpërndarë ushqime e veshje të varfërve. Ajo përfshin gjithashtu ofrimin prej anëtarëve të Kishës të kohës, talenteve, dhembshurisë, materialeve dhe mjeteve financiare që bëhen të disponueshme për peshkopin për të ndihmuar në përkujdesjen për të varfrit dhe nevojtaret. Atëherë, magazina e Zotit ekziston në çdo lagje. Këto oferta duhen "hedhur në shtëpinë e ruajtjes së Zotit, . . . cilido duke kërkuar interesin e të afërmit të tij dhe duke bërë gjithçka me syrin drejtuar te lavdia e Perëndisë" (DeB 82:18–19). Peshkopi është administruesi i magazinës së Zotit.

## 6.2 Udhëheqja e Mirëqenies në Lagje

### 6.2.1 Peshkopi

Peshkopi drejton punën për mirëqenie në lagje. Ai ka një urdhër hyjnor për të kërkuar dhe për t'u kujdesur për të varfrit (shih DeB 84:112). Synimi i tij është të ndihmojë anëtarët që të ndihmojnë veten dhe që të bëhen të mbështetur tek vetja.

Këshilltarët e peshkopit, presidentja e Shoqatës së Ndhmës, udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë, presidenti i kuorumit të pleqve dhe anëtarët e tjerë të këshillit të lagjes, ndihmojnë peshkopin në përmbushjen e këtyre përgjegjësi.

Peshkopi ruan konfidencialitetin mbi ndihmën për mirëqenie që marrin anëtarët. Ai ruan me kujdes privatësinë dhe dinjitetin e anëtarëve që marrin ndihmë. Kur e ndien se udhëheqës të tjerë të lagjes mund të ndihmojnë anëtarët në nevojë, ai mund të tregojë informacion sipas udhëzimeve në 6.4.

Informacioni mëtejshëm mbi përgjegjësitë e peshkopit për mirëqenien, përfshirë udhëzimet për administrimin e ndihmës nga fondet e ofertës së agjërimit, jepet në *Handbook 1 [Manuali 1]*, 5.2.

## 6.2.2 Këshilli i Lagjes

Në mbledhjet e keshillit të lagjes, peshkopi jep mësim parimet për mirëqenien dhe udhëzon anëtarët e keshillit për përgjegjësitë e tyre për mirëqenien. Anëtarët e keshillit marrin parasysh çështjet e mirëqenies shpirtërore dhe fizike si vijon:

Ata këshillohen së bashku mbi mënyrat se si të ndihmojnë anëtarët e lagjes që të kuptojnë dhe ndjekin parimet e mirëqenies.

Ata raportojnë mbi nevojat për mirëqenie shpirtërore dhe fizike në lagje, duke përdorur informacion nga vizitat e tyre personale dhe nga raportet e mësimave të shtëpisë dhe të vizitave mësimore. Kur informacioni mund të jetë tepër konfidencial sa të ndahet me të gjithë keshillin e lagjes, udhëheqësit flasin veçmas me peshkopin ose në mbledhjet e komitetit ekzekutiv të priftërisë (shih 6.2.3).

Ata planifikojnë mënyra se si të ndihmojnë anëtarët të veçantë të lagjes që të plotësojnë nevojat e tyre shpirtërore dhe fizike, përfshirë nevojat afatgjata. Ata vendosin se si të ndihmojnë anëtarët që kanë paaftësi ose nevoja të tjera të veçanta. Ata i mbajnë konfidenciale këto diskutime (shih 6.4).

Ata bashkërendojnë përpjekjet për të siguruar që anëtarët të cilët marrin ndihmë nga Kisha, të kenë mundësi për të punuar ose për të dhënë shërbim. Ata hartojnë dhe mbajnë një listë mundësish kuptimplote pune. Nëse në zonë ekzistojnë institucione të mirëqenies të Kishës, këto veprime mund të sigurojnë mundësi pune dhe trajnim për njerëzit që u duhet ndihmë nga Kisha.

Ata hartojnë dhe mbajnë një listë të anëtarëve të lagjes, aftësitë e të cilëve mund të jenë të dobishme për t'iu përgjigjur nevojave afatshkurtra, afatgjata ose të shkaktuara nga katastrofat.

Ata zhvillojnë dhe mbajnë një plan të thjeshtë të shkruar për lagjen që t'iu përgjigjet rasteve urgjente (shih *Handbook 1 [Manuali 1]*, 5.2.11). Ata e bashkërendojnë këtë plan me plane të ngjashme në kunj dhe në komunitet.

## 6.2.3 Komiteti Ekzekutiv i Priftërisë i Lagjes

Si të nevojitet, komiteti ekzekutiv i priftërisë i lagjes diskuton çështje konfidenciale të mirëqenies. Peshkopi mund të ftojë presidenten e Shoqatës së Ndhimës që të marrë pjesë në këto diskutime.

## 6.2.4 Grupi i Priftërinjve të Lartë, Kuorumi i Pleqve dhe Shoqata e Ndhimës

Mirëqenia është thelbësore në punën e grupit të priftërinjve të lartë, të kuoromit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndhimës. Në mbledhjet e udhëheqjes

së grupit të priftërinjve të lartë, presidentes së kuoromit të pleqve dhe të presidentes së Shoqatës së Ndhimës, udhëheqësit planifikojnë mënyra për t'i dhënë mësim parimet e mbështetjes tek vetja e të shërbimit dhe adresimit të nevojave për mirëqenie. Nën drejtimin e peshkopit, këta udhëheqës i ndihmojnë anëtarët që të bëhen të mbështetur tek vetja dhe të gjejnë zgjidhje për probleme afatshkurtra dhe afatgjata të mirëqenies.

## Nevojat Afatshkurtra të Mirëqenies

Ndërsa peshkopi siguron ndihmë afatshkurter, ai mund t'iu japë detyra udhëheqësve të Priftërisë Melkizedeke ose të Shoqatës së Ndhimës.

Peshkopi normalisht cakton presidenten e Shoqatës së Ndhimës që të vizitojë anëtarët, të cilëve u nevojitet ndihmë afatshkurter. Ajo ndihmon për të vlerësuar nevojat e tyre dhe i sugjeron peshkopit se çfarë ndihme të sigurojë. Peshkopi mund t'iu kërkojë asaj që të përgatisë një formular Bishop's Order for Commodities [Urdhër i Peshkopit për Artikuj] që ai ta miratojë dhe ta nënshkruajë.

Roli i presidentes së Shoqatës së Ndhimës në kryerjen e këtyre vizitave për vlerësim të nevojave të familjeve, shpjegohet më gjerësisht në 9.6.1. Për informacion rreth përgjegjësisë të tjera afatshkurtra të mirëqenies, që zbatohen posaçërisht për presidenten e Shoqatës së Ndhimës dhe keshilltaret e saj, shih 9.6.2 dhe 9.6.3.

## Nevojat Afatgjata të Mirëqenies

Shumë probleme afatshkurtra shkaktohen nga vështirësi afatgjata, të tilla si shëndeti i dobët, mungesë aftësish, arsimim ose punësim i papërshtatshëm, zakone personale dhe sfida emocionale. Udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhimës kanë një përgjegjësi të veçantë për t'iu ndihmuar anëtarët që t'iu trajtojnë këto shqetësime. Synimi i tyre është të trajtohen problemet afatgjata në mënyra të tilla, që çojnë në ndryshim të qëndrueshëm.

Ndërsa udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhimës informohen për nevojat afatgjata, ata përgjigjen me dhembshuri për të ndihmuar individët dhe familjet. Ata përdorin burime të disponueshme në organizatat e tyre dhe në lagje. Ata lutën për udhëheqje që të dinë se si të sigurojnë ndihmë.

Për të pasur një kuptueshmëri më të mirë për mënyrën se si të ndihmojnë, udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhimës normalisht vizitojnë anëtarët që kanë nevoja për mirëqenie. Ata mund të përdorin formularin Needs and Resources Analysis [Analizë e

Nevojave dhe e Burimeve] ose ndryshe t'i ndjekin parimet e tij për të ndihmuar anëtarët që të planifikojnë mënyra se si t'u përgjigjen nevojave për mirëqenie.

Ndërsa udhëheqësit ndihmojnë anëtarët që t'u përgjigjen nevojave afatgjata, ata këshillohen me peshkopin. Në disa raste, udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës punojnë së bashku.

#### Raportimi te Peshkopi dhe Kërkimi i Drejtimit të Vazhdueshëm prej Tij

Udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë, presidenti i kuorumit të pleqve dhe presidentja e Shoqatës së Ndihmës, i raportojnë rregullisht peshkopit mbi veprimet që po ndërmarrin ata dhe organizatat e tyre për të trajtuar nevojat afatshkurtra dhe afatgjata për mirëqenie në lagje. Ata kërkojnë drejtimin e vazhdueshëm të peshkopit për përpjekjet e tyre për mirëqenie.

Nëse individët dhe familjet kanë probleme afatshkurtra që ata nuk mund t'i zgjidhin vetë dhe që udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës nuk mund t'i zgjidhin, udhëheqësit njoftojnë menjëherë peshkopin.

Nëse udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe udhëheqëset e Shoqatës së Ndihmës mësojnë për probleme të mundshme në lidhje me denjësinë ose çështje delikate familjare, ata i drejtojnë anëtarët të peshkopi.

#### Mësuesit e Shtëpisë dhe Mësueset Vizitore

Ndihma për mirëqenien shpirtërore dhe fizike shpesh fillon me mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore. Me një qëndrim dashamirësie dhe miqësie që shkon përtej vizitave mujore, mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore ndihmojnë individët dhe familjet në nevojë. Ata ua raportojnë nevojat e atyre të cilëve u shërbejnë, udhëheqësve të tyre të priftërisë ose të Shoqatës së Ndihmës.

#### Kërkimi i Shërbimit nga Anëtarët e Kuorumit e të Shoqatës së Ndihmës dhe të Tjerët

Udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës mund të kërkojnë shërbimin e anëtarëve, aftësitë ose përvoja e të cilëve, mund t'i ndihmonte ata në nevojë. Anëtarët mund të sigurojnë shërbim afatshkurter të tillë si sigurimi i vakteve ushqimore ose kujdesit për fëmijët, ose ndarja e informacionit mbi punësim të disponueshëm. Anëtarët gjithashtu mund të sigurojnë udhëzim për të ndihmuar për nevojat afatgjata për mirëqenie, të tilla si shëndet, higjienë, ushqyerje, përgatitja për një karrierë, gjetja e mundësive për

arsim, fillimi i një biznesi të vogël ose administrimi i financave familjare.

Pasi udhëheqësit u kërkojnë të tjerëve që të sigurojnë ndihmë, ata mbeten në kontakt me individin ose familjen në nevojë për të siguruar inkurajim dhe për të ndihmuar në mënyra të tjera si të jetë e nevojshme.

Udhëheqësit mund të ndihmojnë peshkopin kur ai drejton anëtarët tek institucionet e mirëqenies të Kishës të tilla si magazinat e peshkopëve, qendrat e burimeve për punësim të Kishës, Deseret Industries dhe Shërbimet Familjare SHDM. Udhëheqësit mund t'i ndihmojnë anëtarët gjithashtu që të marrin ndihmë nëpërmjet komunitetit dhe agjencive qeveritare.

#### 6.2.5 Specialistët e Mirëqenies për Lagjen

Specialistët e mirëqenies për lagjen shërbejnë si burime për të ndihmuar peshkopatën dhe për të ndihmuar udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës që të kryejnë detyrat e tyre të mirëqenies.

Peshkopata mund të thërrasë një specialist punësimi që të ndihmojë anëtarët të përgatiten e të gjejnë punësim të përshtatshëm. Peshkopata mund të thërrasë gjithashtu specialistë të tjerë të mirëqenies për të ndihmuar anëtarët për nevoja të tilla si arsimimi, trajnimi, ushqyerja, higjiena, ruajtja në shtëpi, kujdesi shëndetësor, financat familjare dhe Fondi i Përhershëm Arsimor.

### 6.3 Udhëheqja e Mirëqenies në Kunj

#### 6.3.1 Presidenti i Kunjtit

Presidenti i kunjtit mbikëqyr punën e mirëqenies në kunj. Më shumë informacion mbi përgjegjësitë e tij për mirëqenien jepet në *Handbook 1 [Manuali 1]*, 5.1.

#### 6.3.2 Këshilli i Kunjtit

Në mbledhjet e këshillit të kunjtit, udhëheqësit marrin parasysh çështjet e mirëqenies shpirtërore dhe fizike si vijon:

Ata dallojnë problemet e mirëqenies në kunj dhe kërkojnë mënyra për t'i trajtuar ato probleme. Megjithatë, ata nuk marrin përgjegjësi që të zgjidhin çështje të mirëqenies të lagjes.

Ata planifikojnë mënyra për t'u mësuar parimet e mirëqenies udhëheqësve të kunjtit dhe të lagjes.

Ata diskutojnë mënyra për t'i bërë të vetëdijshëm udhëheqësit e lagjes për njerëzit në kunj, të

cilët mund të shërbejnë si burime për të ndihmuar për nevojat e mirëqenies.

Ata zhvillojnë dhe mbajnë një plan të thjeshtë të shkruar për kunjin që t'u përgjigjet rasteve urgjente (shih *Handbook 1 [Manuali 1]*, 5.1.3). Ky plan duhet të bashkërendohet me plane të ngjashme të kunjeve të tjera në këshillin bashkërendues dhe me planet në komunitet.

Ata planifikojnë aktivitete për mirëqenien, duke u kujdesur që të mos vënë ngarkesa të tepëra mbi udhëheqësit e lagjes.

Ata planifikojnë mënyra për t'iu përgjigjur detyrave për mirëqenie të kunjit.

Kur caktohen nga një anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve ose Presidenca e Zonës, ata sigurojnë udhëheqje dhe mbështetje për një operacion për mirëqenien.

Nëse një peshkop caktohet që të trajtojë kërkesa për ndihmë për njerëzit që kanë qëndrim të përkohshëm ose janë të pastrehë, anëtarët e këshillit të kunjit përcaktojnë se si t'i bëjnë burimet e kunjit të disponueshme për atë peshkop.

### 6.3.3 Specialistët e Mirëqenies të Kunjit

Një anëtar i presidencës së kunjit ose një këshilltar i lartë i caktuar mund të thërrasë një specialist punësimi të kunjit dhe specialistë të tjerë të mirëqenies. Këta specialistë të kunjit shërbejnë si

burime për peshkopët dhe udhëheqës të tjerë të lagjes. Specialistët mund të ndihmojnë për nevoja të mirëqenies të tilla si ato të renditura në 6.2.5.

---

## 6.4 Konfidencialiteti

Kur peshkopi dhe udhëheqës të tjerë të lagjes mësojnë për nevojat për mirëqenie të anëtarëve dhe ndihmën që është siguruar, ata mbajnë konfidencialitetin për atë informacion. Ata ruajnë me kujdes privatësinë dhe dinjitetin e anëtarëve që marrin ndihmë. Ata janë të kujdesshëm që të mos vënë në siklet anëtarët që kanë nevojë për ndihmë.

Mund të ketë herë kur do të ishte e dobishme që i gjithë këshilli i lagjes dhe ndoshta anëtarë të tjerë të lagjes, të vihen në dijeni mbi nevojat për mirëqenie të një individi ose familjeje. Për shembull, kur një anëtar është i papunë ose po kërkon një punë më të mirë, të tjerë mund të jenë në gjendje ta ndihmojnë atë anëtar që të gjejë punë më shpejt. Në raste të tilla, peshkopi dhe udhëheqësit e tjerë në përgjithësi kërkojnë lejen e anëtarëve në nevojë që të tregojnë informacion mbi situatën e tij.

Kur udhëheqësit u kërkojnë të tjerëve që të ndihmojnë, ata tregojnë vetëm informacionin e nevojshëm për ta përmbushur detyrën. Udhëheqësit i udhëzojnë ata gjithashtu që të ruajnë konfidencialitetin.

---

## 17. Njëtrajtshmëria dhe Përshtatja

<b>17.1</b>	<b>Ku Kërkohet Njëtrajtshmëria . . . . .</b>	<b>132</b>	<b>17.2</b>	<b>Rrethana që Mund të Lejojnë</b>	
17.1.1	Shkrimet e Shenjta . . . . .	132	<b>Përshtatje Vendore . . . . .</b>	<b>133</b>	
17.1.2	Urdhërimet dhe Standardet . . . . .	132	17.2.1	Rrethanat Familjare . . . . .	134
17.1.3	Pastërtia e Doktrinës . . . . .	132	17.2.2	Transporti dhe Komunikacioni . . . . .	134
17.1.4	Mbledhjet e Sakramentit dhe Programi i Mbledhjeve të së Dieles . . . . .	132	17.2.3	Masa e Vogël e Kuorumit ose Klasës . . . . .	134
17.1.5	Konferencat . . . . .	133	17.2.4	Burimet e Udhëheqjes . . . . .	135
17.1.6	Puna e Tempullit . . . . .	133	17.2.5	Siguria . . . . .	135
17.1.7	Këshillat Disiplinore . . . . .	133			
17.1.8	Dokumentet dhe Raportet . . . . .	133			
17.1.9	Ordinancat . . . . .	133			
17.1.10	Programi Mësimor . . . . .	133			

## 17. Njëtrajtshmëria dhe Përshtatja

Anëtarët e Kishës jetojnë në një larmi të gjerë kushtesh politike, shoqërore dhe ekonomike. Lagjet dhe degët gjithashtu ndryshojnë në madhësi dhe burime për udhëheqje. Këto kushte mund të kërkojnë që udhëheqësit vendorë të përshtasin disa programe të Kishës. Përshtatje të tilla në mënyrë tipike ndikojnë organizatat ndihmëse, mbledhjet e udhëheqjes dhe programet e aktiviteteve. Udhëzimet në këtë kapitull kanë për qëllim të ndihmojnë udhëheqësit e priftërisë që të përcaktojnë se cilat përshtatje mund të jenë me vend dhe cilat jo.

Të gjitha lagjet dhe degët, pavarësisht nga përmasat ose rrethanat e tyre, mund të përfjetojnë të njëjtin bollëk të Shpirtit të Zotit. Shpëtimtari dha mësim: “Kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin tim, unë jam në mes të tyre” (Mateu 18:20).

### 17.1 Ku Kërkohet Njëtrajtshmëria

Për të ditur se cilat përshtatje mund të jenë me vend, udhëheqësit së pari duhet të kuptojnë doktrinat, ordinancat dhe praktikat që janë vendosur nga shkrimet e shenjta dhe mësimet e profetëve e të apostujve të ditëve të mëvonshme. Këto duhet të jenë të njëtrajtshme në mbarë Kishën.

Presidentët e kunjeve, peshkopët dhe udhëheqës të tjerë vendorë kanë një detyrim të shenjtë që të mbajnë njëtrajtshmërinë dhe pastërtinë e Kishës në të gjitha kategoritë e përvijuara më poshtë. Kjo nevojë për njëtrajtshmëri bazohet në parimin e shkrimit të shenjtë “një Zot i vetëm, një besim i vetëm, një pagëzim i vetëm” (Efesianëve 4:5; shih edhe Mosia 18:21).

#### 17.1.1 Shkrimet e Shenjta

Veprat standarde të Kishës janë Bibla e Shenjtë, Libri i Mormonit, Doktrina e Besëlidhje dhe Perla me Vlerë të Madhe. Në shumë gjuhë, Kisha ka miratuar një botim të Biblës për t’u përdorur në mbledhjet dhe orët mësimore të Kishës. Po ashtu, duhet të përdoret botimi më i fundit i autorizuar i tre librave të tjerë të shkrimeve të shenjta të shenjtorëve të ditëve të mëvonshme. Nuk duhet të reklamohen ose të përdoren vepra të tjera si shkrim i shenjtë në Kishë.

#### 17.1.2 Urdhërimet dhe Standardet

Urdhërimet e Zotit dhe standardet e denjësisë të Kishës jepen në shkrimet e shenjta dhe në komunikimet zyrtare nga Presidenca e Parë.

Udhëheqësit vendorë nuk duhet t’i ndryshojnë këto urdhërime dhe standarde. Udhëheqësit vendorë nuk duhet as të japin mësim rregullat ose interpretimet e tyre në lidhje me urdhërimet.

Standardet e denjësisë për pjesëmarrje në tempull jepen hollësisht në pyetjet e intervistës që gjendet në librin e rekomandimit për në tempull. Udhëheqësit vendorë nuk duhet t’i ndryshojnë ato.

#### 17.1.3 Pastërtia e Doktrinës

Doktrinat e Kishës gjenden në shkrimet e shenjta dhe në mësimet e profetëve e të apostujve të ditëve të mëvonshme. Zoti udhëzoi: “Pleqtë, priftërinjtë dhe mësuesit e kësaj kishë do t’u mësojnë parimet e ungjillit tim, të cilat janë në Bibël dhe në Librin e Mormonit, në të cilin është plotësia e ungjillit” (DeB 42:12; shih edhe DeB 52:9, 36).

Të gjithë udhëheqësit duhet të sigurohen që në Kishë të jepet mësim doktrina e vërtetë. Nëse një person jep mësim doktrinë të rreme ose të shtrembëruar, udhëheqësit duhet ta korrigjojnë këtë sakaq dhe me ndjeshmëri. Gabimet zakonisht mund të korrigjohen privatisht, por gabime të mëdha ose të përsëritura mund të kërkojnë korrigjim në publik.

Nëse udhëheqësit vendorë janë të pasigurt se cilat doktrina ose mësim janë të sakta mbi një temë të dhënë, ata mund të kërkojnë drejtim nga autoriteti i tyre kryesues më i afërt.

#### 17.1.4 Mbledhjet e Sakramentit dhe Programi i Mbledhjeve të së Dielës

Mbajtja e mbledhjeve të sakramentit është një urdhër i shkrimit të shenjtë (shih DeB 59:9). Udhëzimet për mbledhjet e sakramentit jepen në 18.2.2. Programi i mbledhjeve të së dielës paraqitet në faqen 153. Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve e kanë hartuar këtë program. Udhëheqësit vendorë nuk duhet ta ndryshojnë atë.

Në situata të skajshme, udhëheqësit vendorë mund të anulojnë mbledhje të së dielës. Megjithatë, bërja e kësaj duhet të jetë një ngjarje e rrallë. Shembuj të situatave që mund të justifikojnë anulimin e mbledhjeve përfshijnë probleme urgjente të sigurisë dhe mot të ashpër. Nëse është e mundur, peshkopi duhet të këshillohet me presidentin e kunjit përpara se të anulohet mbledhjet.

Nganjëherë, një situatë e pazakontë vendore mund ta bëjë të nevojshme që të ndryshohet

programi i së dielës për një periudhë më të gjatë. Për shembull, mund të jetë i nevojshëm një ndryshim nëse një shtëpi mbledhesh është dëmtuar nga zjarri, përmytja ose stuhia. Në një rrethanë të tillë, presidenti i kunjtit kërkon drejtim nga Presidenca e Zonës ose I Shtatëdhjeti Zonal që kryeson në këshillin e tij bashkërendues.

Udhëheqësit e degëve shumë të vogla në numër mund ta përshtasin programin e së dielës si të drejtohen nga udhëheqësit e tyre, duke përdorur *Udhëzuesin për Programin e Njësisë Bazë*.

#### 17.1.5 Konferencat

Secili kunj zhvillon dy konferenca kunjti gjatë vitit siç programohet nga Presidenti i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve (shih 18.3.1).

Presidenca e kunjtit programon, organizon dhe kryeson në një konferencë të lagjes ose degës çdo vit për secilën lagje ose degë në kunj (shih 18.2.5). Presidenti i distriktit bën të njëjtën gjë për secilën degë në një distrikt.

#### 17.1.6 Puna e Tempullit

Puna e shenjtë e tempujve është nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Presidentit të Kishës. Të gjitha çështjet që lidhen me punën e tempullit duhet të trajtohen sipas udhëzimeve në *Handbook 1 [Manualin 1]*, kapitulli 3. Shembuj të çështjeve të tilla përfshijnë rekomandimet për në tempull, vulosjet, lejet e vulosjeve dhe anulimet e vulosjeve. Nëse një president kunjti has një pyetje që ai nuk mund ta zgjidhë, ai ia drejton atë Zyrës së Presidencës së Parë.

Udhëheqësit vendorë sigurohen që frazeologjia e tempullit dhe ordinancat e besëlidhjet e shenjtë të tempullit të mos diskutohen në terma të veçanta në mbledhjet e Kishës.

#### 17.1.7 Këshillat Disiplinore

Udhëzimet për këshillat disiplinore jepen në *Handbook 1 [Manualin 1]*, kapitulli 6. Udhëheqësit nuk duhet të shmangen nga këto udhëzime, përfshirë kërkesat për paraqitjen e raporteve. Nëse një president kunjti has një pyetje që ai nuk mund ta zgjidhë, ai ia drejton atë Zyrës së Presidencës së Parë.

#### 17.1.8 Dokumentet dhe Raportet

Mbajtja e dokumenteve të Kishës është një urdhër i shkrimit të shenjtë (shih DeB 20:81–83). Dokumentet dhe raportet e kërkuara përvijohen në *Handbook 1 [Manualin 1]*, kapitulli 13. Presidenca e Parë mund t'i përmirësojë ato herë pas here.

Dokumentet dhe raportet e Kishës përgatiten duke përdorur sistemet kompjuterike të Kishës ose me shkrim, në varësi nga zona. Udhëheqësit sigurohen që dokumentet dhe raportet të jenë të sakta dhe të paraqiten në kohë.

#### 17.1.9 Ordinancat

Udhëzimet për kryerjen e ordinancave të priftërisë përvijohen në kapitullin 20. Këto udhëzime nuk duhet të ndryshohen. Moshat minimale për marrjen e ordinancave të tilla si pagëzimi dhe shugurimi në detyrat e Priftërisë Aarone nuk mund të ndryshohen për asnjë arsye.

#### 17.1.10 Programi Mësimor

Në orët mësimore që zhvillohen gjatë programit të mbledhjeve të së dielës, duhet të përdoren materialet e programit mësimor të miratuar nga Kisha. Këto materiale përfshijnë manuale të prodhuara nga Kisha, revista dhe burime plotësuese mësimdhënieje. Në nivel vendor nuk duhet të zhvillohen manuale dhe kurse të reja.

Peshkopët dhe presidentët e degëve herë pas here mund të japin mësim ose të autorizojnë një mësim të veçantë të priftërisë ose të organizatave ndihmëse kur ata e ndiejnë se ka një nevojë.

#### 17.2 Rrethana që Mund të Lejojnë Përshtatje Vendorë

Presidentët e kunjeve, peshkopët dhe presidentët e degëve të tregohen të matur për të bërë përshtatje të thjeshta për disa programe të Kishës. Kur nevojitet, përshtatje të tilla mund të bëhen si vijon:

1. Në organikën dhe programet e organizatave ndihmëse
2. Në formatin dhe shpeshtësinë e mbledhjeve të udhëheqjes
3. Në formatin dhe shpeshtësinë e aktiviteteve

Kur marrin parasysh se cilat përshtatje mund të jenë me vend, presidenca e kunjtit, peshkopata, ose presidenca e degës këshillohen midis tyre dhe gjithashtu me këshillin e kunjtit, lagjes ose degës. Ata këshillohen gjithashtu me autoritetin e tyre kryesues më të afërt nëse rrethanat mund ta justifikojnë një përshtatje më të madhe ose të pazakontë. Udhëheqësit duhet të kërkojnë gjithmonë udhëheqjen e Shpirtit kur bëjnë përshtatje.

Udhëheqësit mund të marrin parasysh faktorët vijues kur përcaktojnë se çfarë përshtatjesh mund të jenë me vend.

### 17.2.1 Rrethanat Familjare

Kur japin thirrje, programojnë mbledhje të udhëheqjes dhe planifikojnë aktivitetet, udhëheqësit marrin parasysh rrethanat familjare të anëtarëve. Shërbimi dhe pjesëmarrja në Kishë gjithmonë përfshin një masë sakrifice. Megjithatë, familjet e forta janë jetike për Kishën dhe anëtarëve nuk duhet t'u kërkohej të bëjnë sakrifica të tepërta familjare për të shërbyer ose për të mbështetur programe apo aktivitetet.

Një rrethanë familjare për t'u marrë parasysh është thirrja/thirrjet në Kishë që mbahen nga bashkëshorti ose bashkëshortja e një anëtarjeje/anëtari. Familjet e veçanta nuk duhet të mbingarkohen me përgjegjësi në Kishë. Një rrethanë tjetër për t'u marrë parasysh është kërkesat e përgjithshme kohore që hasin anëtarët për mbështetjen e familjeve të tyre dhe për kujdesin për çështje të tjera personale. Në disa zona të botës, anëtarët për nevojë punojnë në dy apo tre punë. Këto janë konsiderata të përligjura që udhëheqësit duhet t'i peshojnë kur japin thirrje, programojnë mbledhje të udhëheqjes dhe planifikojnë aktivitetet.

### 17.2.2 Transporti dhe Komunikacioni

Disa kune ose lagje mbulojnë zona të mëdha gjeografike, që u kërkojnë anëtarëve të udhëtojnë në distanca të mëdha për në mbledhje dhe aktivitetet. Kur vlerësojnë nevojat për mbledhje dhe aktivitetet, udhëheqësit marrin parasysh kohën dhe shpenzimet e kërkuara për udhëtimin nga anëtarët.

Në shumë zona të botës, automjetet nuk janë të zakonshëm dhe transporti kryhet në këmbë, me biçikletë, autobus dhe tramvaj. Kur distancat janë të mëdha, këto kushte mund të tregojnë se udhëheqësit duhet t'i përshtasin programet e Kishës dhe mbledhjet e udhëheqjes që ta bëjnë më të lehtë pjesëmarrjen për anëtarët.

Edhe aty ku automjetet janë të disponueshme gjerësisht, udhëheqësit duhet të jenë të ndjeshëm ndaj kostos së udhëtimit në distanca të gjata. Në disa raste, të tilla si drejtimi i punëve të këshillit të lartë, udhëheqësit mund të përdorin telefonata konference, mesazhe elektronike si dhe internetin për të zvogëluar transportin e kushtueshëm. Kur të përdorin këto burime, udhëheqësit duhet të kenë kujdesje të veçantë për të siguruar konfidencialitetin.

Anëtarët në periudha të ndryshme të jetës shpesh ndryshojnë gjerësisht në qasjen e tyre tek transporti. Për shembull, të rinjtë në moshë madhore beqarë shpesh lëvizin më shumë se familjet me fëmijë dhe nganjëherë kanë burimet për të udhëtuar në distanca më të mëdha. Aty ku të

rinjtë në moshë madhore beqarë janë në gjendje të mblidhen me shpenzime dhe kohë të arsyeshme, ata duhet të kenë aktivitetet grupkunjëshe me shpeshtësi të përmbajtur (shih 13.3.1).

Në disa pjesë të botës, telefonat janë të shtrenjtë dhe shumë anëtarë nuk zotërojnë një të tillë. Po ashtu, qasja te mesazhet elektronike dhe interneti është e rrallë në disa zona. Nëse këto burime janë të shtrenjta ose jo të disponueshme përgjithësisht, udhëheqësit duhet të bëjnë përshtatjet e nevojshme.

Aty ku udhëtimi është i vështirë ose i kushtueshëm dhe burimet e komunikimit janë të pamjaftueshme, mësimi i shtëpisë dhe vizitat mësimore janë më sfiduese. Në raste të tilla, udhëheqësit mund të bëjnë përshtatje siç përvijohet në 7.4.3 dhe 9.5.3.

### 17.2.3 Masa e Vogël e Kuorunit ose Klasës

#### Pleqtë dhe Priftërinjtë e Lartë

Nëse shumë pak pleq ose priftërinj të lartë lagje janë në gjendje të marrin pjesë në mbledhjen e priftërisë të dielën, ata mund të mblidhen së bashku. Megjithatë, në asnjë rast nuk duhet të krijohet një kuorum i vetëm i Priftërisë Melkize-deke. Për aq kohë sa të ketë pleq dhe priftërinj të lartë të shuguruar në lagje, duhet të organizohen edhe një kuorum i pleqve edhe një grup i priftërinjve të lartë.

Për shkak se distriktet nuk kanë kuorume të priftërinjve të lartë, degët në distrikte nuk kanë grupe të priftërinjve të lartë. Priftërinjtë e lartë që marrin pjesë në këto degë, mblidhen me kuorumin e pleqve.

#### Të Rinjtë dhe Të Rejat

Në një lagje ose degë me pak të rinj, kuoromet e Priftërisë Aarone mund të mblidhen së bashku për udhëzim dhe aktivitetet (shih 8.11 dhe 8.13.1). Megjithatë, kuoromet e veçanta përsëri duhet të organizohen, me udhëheqës që thirren dhe mbështeten për çdo kuorum.

Në një lagje ose degë me pak të reja, ato mund të mblidhen së bashku për udhëzim dhe aktivitetet (shih 10.6.2 dhe 10.8.1). Një presidencë klase mund të thirret për çdo grup-moshë, ose një presidencë mund të thirret për grup-mosha të ndërthurura derisa ato të jenë në gjendje të organizohen në klasat e tyre përkatëse.

Nëse udhëheqja në moshë madhore është e kufizuar, presidenca e Të Rinjve mund të japë mësim mësimet e së dielës dhe të drejtojë programin e aktiviteteve pa këshilltarë ndihmues. Presidenca

e Të Rejave mund të bëjë të njëjtën gjë për të rejat. Në një njësi shumë të vogël, presidentët e Të Rinjve dhe të Të Rejave mund të jenë të vetmit udhëheqës të rritur në organizatat e tyre. Nëse është ky rast, ata zhvillojnë mësimet e së dielës dhe mbikëqyrin aktivitetet për të gjithë të rinjtë ose të rejat. Kur është e mundur, këshilltarët dhe një sekretar duhet të thirren për çdo organizatë.

Për shkak se rinia shpesh përfiton nga shoqërimi në grupe më të mëdhenj, të rinjtë dhe të rejat në dy ose më shumë lagje apo degë të vogla mund të mblidhen herë pas here për aktivitete të ndërthurura. Nëse lagjet dhe degët fqinje kanë pak të rinj ose të reja, peshkopët dhe presidentët e degëve mund të autorizojnë rininë që të mblidhen së bashku për aktivitetet javore. Kur marrin parasysh këto variante, udhëheqësit marrin parasysh faktorë të tillë si largësia dhe kostot e udhëtimit.

Aktivitetet periodike të kunjtit ose grup-kunjthe janë veçanërisht të rëndësishme aty ku lagjet ose degët kanë numër të vogël të të rinjve (shih 13.3 dhe 13.4).

Në një kunj ose distrikt të vogël, presidenti i Të Rinjve mund të jetë udhëheqësi i vetëm i Të Rinjve në kunj ose distrikt. E njëjta gjë mund të jetë e vërtetë për presidenten e Të Rejave në kunj ose distrikt. Kur është e mundur, këshilltarët dhe një sekretar duhet të thirren për çdo organizatë.

#### Fillorja

Në një lagje ose degë me pak fëmijë, presidenca e Fillores mund të dëshirojë të organizojë më pak klasa, duke ndërthurur grup-moshat.

Në një lagje ose degë të vogël, presidenca e Fillores mund të jenë të vetmet udhëheqëse dhe mësuese të Fillores. Në një njësi shumë të vogël, presidentja e Fillores mund të jetë udhëheqësja e vetme e Fillores. Në këtë rast, ajo drejton kohën e përbashkët dhe jep mësim në një klasë për të gjithë fëmijët. Kur është e mundur, duhet të thirren udhëheqëse dhe mësuese të tjera siç përvijohet në 11.7.

Në një kunj ose distrikt të vogël, presidentja e Fillores mund të jetë udhëheqësja e vetme e Fillores në kunj ose distrikt. Kur është e mundur, duhet të thirren udhëheqës të tjerë siç përvijohet në 11.7.

#### 17.2.4 Burimet e Udhëheqjes

Kur nuk ka mjaftueshëm anëtarë të kualifikuar për të plotësuar të gjithë pozicionet udhëheqëse, udhëheqësit kryesues mund të plotësojnë vetëm ato që janë më thelbësoret. Përveç që të thërrasin anëtarë aktivë e me përvojë në pozicione udhëheqëse, udhëheqësit kryesues duhet të kërkojnë frymëzim për të gjetur udhëheqës të tjerë të mundshëm mes anëtarëve të rinj, anëtarëve të papërvojë dhe anëtarëve më pak aktivë që do të mund të ktheheshin në aktivitet. Anëtarët e Kishës nuk ka nevojë të kenë përvojë ose të jenë tepër të kualifikuar për të marrë një thirrje. Marrja e një thirrjeje është një mënyrë e rëndësishme për ata që të shërbejnë dhe të rriten shpirtërisht.

Kur nuk ka mjaftueshëm anëtarë që të shërbejnë në pozicione udhëheqëse, udhëheqësit kryesues mund ta organizojnë kunjin, lagjen ose degën e tyre në një shkallë më të vogël. Shembujt mund të përfshijnë plotësimin e disa organizatave vetëm me një president e një këshilltar, duke e bërë një këshilltar të shërbejë gjithashtu si sekretar dhe duke thjeshtuar disa programe.

Në një degë shumë të vogël që nuk ka presidente të Të Rejave ose të Fillores, presidentja e Shoqatës së Ndhimës mund të ndihmojë prindërit të organizojnë udhëzimin për të rejat dhe fëmijët derisa të thirren presidentet e Të Rejave dhe të Fillores.

Udhëheqësit e degëve shumë të vogla ndjekin udhëzimet në *Udhëzuesin për Programin e Njësisë Bazë*.

#### 17.2.5 Siguria

Në disa zona të botës, shkalla e krimit është shumë e lartë ose mbizotërojnë trazira politike. Nëse udhëheqësit në këto zona besojnë se është e pamatur që anëtarët të udhëtojnë natën, ata mund të anulojnë aktivitetet e mbrëmjes. Kjo mund të kuptojë zvogëlimin e numrit të aktiviteteve të Kishës, si edhe programimin e disa aktiviteteve në fundjavë.

Kur rreziqet e sigurisë ose kostot e udhëtimit janë çështje serioze, udhëheqësit mund të programojnë të dielën disa aktivitete të rinisë. Aktivitetet e tilla duhet të ndahen nga programi i mbledhjeve të së dielës dhe të jenë në harmoni me shpirtin e Shabatit.

